



REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT
Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë



Referencë: **IPK/09082024/DI**
Datë: **09.08.2024**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektim në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit, Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), si dhe Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Prishtinës (Qendër)
Referenca	- 04/2024
Data e inicimit	- 18.03.2024
Data e raportimit	- 09.08.2024
Arsyet e inicimit	- IPK ka mandat të kryejë inspektim në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështet Policinë për të siguruar shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit (2024) ka paraparë kryerjen e inspektimeve për të vlerësuar performancën e stacioneve policore, përfshirë edhe atë të Prishtinës Qendër, në vazhden e monitorimit të angazhimeve policore të këtij niveli të organizimit policor. Inspektimi është me rëndësi për shkak se përmes tij vlerësohet nëse ky Stacioni është duke realizuar objektivat në përmbushje të mandatit ligjor, për të krijuar mjedis të sigurt për qytetarët. Po ashtu, ky inspektim ka ofruar mundësi për t'u njohur me performancën e këtij Stacioni, me fokus të veçantë në fushat, si: burimet njerëzore, operativa, hetimet dhe shërbimet administrative - mbështetëse.
Objektivat e inspektimit	- Vlerësimi i organizimit dhe angazhimit të burimeve njerëzore, - Vlerësimi i aktiviteteve operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, - Vlerësimi i aktiviteteve hetimore në parandalimin dhe luftimin e krimit, - Vlerësimi i kapaciteteve dhe kushteve të punës në Stacion.
Metodologjia e inspektimit	- <u>Takime - intervista</u> me gjashtë (6) drejtues dhe bartës të funksioneve, si: (a) Komandanti i Stacionit Policor, (b) Shefi i Sektorit të Operativës, (c) Shefi i Sektorit të Hetimeve, (d) Shefi i Sektorit të Resurseve, (e) Mbikëqyrësit e ndërrimeve; - <u>Këqyrje - verifikime</u> mbi: sistemimin e personelit, prezencën fizike në punë, respektimin e uniformës - dukjen personale, gjendjen e pajisjeve, adresimin e shkeljeve disiplinore, vlerësimin e rezultateve të punës, reagimin në thirrje, llogaridhënien, procedimin e lëndëve, patrullimin, zbatimin e urdhërësive, raportimin e përdorimit të forcës, trajtimin e të arrestuarve dhe të ndaluarve, planifikimin, policimin në bashkësi, dosjet penale, kujdesin ndaj dëshmitarëve, funksionalitetin e automjeteve, masat e sigurisë, kushtet teknike, etj.;

	- Marrje dokumentesh fizike/elektronike, si: vendime, kontrata, përshkrime të punës, regjistri i vijueshmërisë, raporte të kontrollit, raporte periodike, dosje disiplinore, raporte të vlerësimit të rezultateve, logu ditor, raporte ditore dhe 24 orë, raporte fillestare të incidentit, orari, dosje kundërvajtjesh, urdhëresa, dosje për përdorim force, dosje të ndalimit, kërkesa për verifikim të kaluarës kriminale, plane operative, pro - forma, raporte mbi policimin në bashkësi, dosje të dhunës në familje, zinxhirë të ruajtjes, regjistra dëshmish, regjistri i qasjes në Dhomë të dëshmive, raporte të kontrollit të dëshmive, raporte mbi automjetet, fletë udhëtime, Regjistri i pasurive, Plani i Evakuimit, etj.
Subjekti	- Stacioni Policor - Prishtinë Qendër (Drejtoria Rajonale - Prishtinë)
Afatet e inspektimit	- Fillimi - 20.03.2024; - Përfundimi - 21.03.2024; - Periudha e mbulimit - dy (2) vitet e fundit dhe gjendja aktuale.
Kriteri vlerësues (standardi)	- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, - Kodi i Procedurës Penale, - Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, - Ligji Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, - Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, - Ligji Nr. 05/L-132 për Automjete, - Ligji Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, - Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, - UA Nr. 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, - UA (MPB) Nr. 05/2023 për Procedurat e Kundërvajtjes, - UA Nr. 02/2012 për Përdorimin e Forcës nga Zyrtarët Policor, - UA Nr. 04/2019 për Shkeljet, Masat dhe Procedurën Disiplinore në PK, - UA Nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës, - UA (MI) Nr. 01/2018 për Kontrollimin Teknik të Automjeteve, - Rregullore për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, - Rregullore për Operativë në Policinë e Kosovës, - Rregullore (MF) Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, - PSO - Koha e reagimit (7 shtator 2018), - PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore e hetimit (25.08.2020), - PSO - Sistemet Informative të Policisë së Kosovës, - PSO - Verifikimi i të kaluarës kriminale (22 shkurt 2021), - PSO - Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës (1 tetor 2020), - PSO - Parandalimi dhe Trajtimi i Dhunës në Familje (8 prill 2022), - PSO - Dhomat e dëshmive (15 maj 2014).
Ekipi realizues	- Fitore Gajraku, inspektore, - Kushtrim Jonuzi, inspektor, - Mirsad Puqurica, inspektor, - Servet Tasholli, inspektor, - Shqiponjë Sopi, inspektore, - Teuta Rukolli - Ajeti, inspektore, - Xhavit Fetahaj, inspektor.
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshf Ekzekutiv i IPK-së
Datë	- 09.08.2024

Shkurtesat

DTIK	Drejtoria e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DSP	Drejtoria e Standardeve Profesionale
EDHRT	Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizmi që shpie në Terrorizëm
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Komiteti Lokal për Siguri Publike
KSHPF	Komisioni i Shqyrtimit të Përdorimit të Forcës
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
LPA	Lista e Personelit të Autorizuar
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
PA	Patrullime me Automjet
PK	Patrullime në Këmbë
PKA	Pika të Kontrollit të Automjeteve
PSO	Procedura Standarde e Operimit
PUI	Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca
QOKR	Qendra Operative Komunikuese Rajonale
QPS	Qendra për Punë Sociale
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

Inspektimi nxjerrë në pah se:

- ✦ Nga 15 fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së mbi organizimin dhe burimet njerëzore policore, janë evidentuar disa dobësi në çështjet që kanë të bëjnë me vonesat në riorganizimin e brendshëm dhe ri-sistemimin e personelit, mos furnizimin në disa raste të personelit të uniformuar me pajisje policore (sprej, jelekë dhe radiolidhje), mos përmbushjen e orëve të parapara të trajnimeve të brendshme, mos përfshirjen e një pjese të personelit në programe të ricertifikimit dhe trajnimeve specifike profesionale me natyrë të hetimeve.
- ✦ Nga 15 fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së mbi aktivitetin operativ janë evidentuar dobësi në çështjet që kanë të bëjnë me cilësinë jo të kënaqshme të evidencës së Logut operacional, trendin jo të kënaqshëm të ekzekutimit të urdhëresave të gjykatave dhe mos respektimin e afateve kohore në lëshimin me kohë të vërtetimeve për parashtruesit e kërkesave për verifikim të të kaluarës kriminale.
- ✦ Nga tetë (8) fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së mbi parandalimin dhe hetimin e krimit, janë evidentuar dobësi në mos respektimin në disa raste të zinxhirit të plotë komandues sa i përket procedimit të kallëzimeve penale në Prokurorinë e Shtetit, mos përdorimin në disa raste të paketimeve adekuate për ruajtjen e dëshmimeve, mos realizimin e disa prej formave të kontrollit në Dhomën e dëshmimeve (inspektimet dhe inventarizimet), etj.
- ✦ Nga 10 fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së mbi kushtet teknike të punës dhe të sigurisë, janë evidentuar dobësi në çështjet që lidhen me kapacitetet e paqëndrueshme të parkut të automjeteve dhe mos plotësimin e formularëve të kontrollit të automjeteve nga shfrytëzuesit para përdorimit të tyre. Janë hasur vështirësi në funksionalitetin e pajisjeve të kontraktuara (fotokopjeve).



Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Prishtinës, që të përshpejtojnë procesin e ri-strukturimit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër, si dhe ri-sistemimit të personelit (si pjesë e Drejtorisë së Policisë së Kryeqytetit), konform Strukturës Organizative dhe Listës së Autorizuar të Personelit. Përmbyllja e këtij procesi të marrë parasysht edhe shpërputhjet sa i përket numrit të punonjësve dhe gradave.
2. Për arsye sigurie dhe të nevojave, IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër, që bashkë me Drejtorin e Drejtorisë së Logjistikës, të përkujdeset në furnizimin e Stacionit me sprej kimik, jelek anti - plumb dhe radio lidhje.
3. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit, që në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale dhe Divizionin e Trajnimeve, të ndërmarr hapa në drejtim të përfshirjes më të gjerë të zyrtarëve të uniformuar në programet e trajnimeve të brendshme brenda regjioni dhe atyre të ricertifikimit.
4. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër, që në koordinim me Divizionin e Trajnimeve, të ndërmarrë hapa në drejtim të përfshirjes më të gjerë të personelit të caktuar të hetimeve në trajnime specifike profesionale (kursi themelor i hetimeve dhe kursi i trajnimit të dhunës në familje).

5. *IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Operativës që të analizojnë dhe identifikojnë faktorët që mund të ndikojnë në ndarjen me vonesë të detyrave (caktimi i detyrave) tek patrullat policore dhe që mund të shtyjnë kohën e përgjithshme të reagimit policor në thirrjet e qytetarëve. Identifikimi i faktorëve ndikues duhet të pasohet me ndërmarrje veprimesh, në drejtim të shkurtimit të kohës së reagimit.*
6. *IPK-ja i rekomandon Shefit të Operativës së Stacionit Policor Prishtinë Qendër, që të sigurohet se dosjet e kundërvajtjeve të trafikut, të përcjellura me konfiskim të patentë shoferëve, të jenë të plota dhe të përmbajnë edhe vërtetimet e konfiskimit, si dhe procesverbalet e ekzaminimit të prezencës së alkoolit, për rastet kur janë kryer testimet.*
7. *IPK-ja iu rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër dhe Shefit të Operativës, që të mobilizohen në përmirësimin e performancës së Stacionit në ekzekutimin e urdhërësive të gjykatave, për derisa njësitë policore ngarkohen me to.*
8. *IPK-ja iu rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër dhe Shefit të Operativës, që të ushtrojnë kontrole mbi njësinë përkatëse që merret me ekzekutimin e urdhërësive, që për të gjitha veprimet policore në drejtim të ekzekutimit të tyre, të mbahet evidencë, e cila duhet dokumentuar brenda përmbajtjes së dosjes (të mbahen formularë të veçantë mbi vizitat tek personat e kërkuar).*
9. *IPK-ja iu rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër dhe Shefit të Operativës, që të ushtrojnë kontrole mbi respektimin e afateve në lëshimin me kohë të vërtetimeve për parashtruesit e kërkesave për verifikim të të kaluarës kriminale, për rastet kur për ta nuk ka dosje të hapura.*
10. *IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër dhe Shefit të Hetimeve, që gjatë ushtrimit të kontrollit mbi lëndët para se ato të procedohen në Prokurorinë e Shtetit, të respektohet i tërë zinxhiri komandues përgjatë rrugëtimit të tyre (të respektohet hierarkia e kontrollit në mënyrë që kallëzimet të kalojnë nga hetuesi i lëndës, tek mbikëqyrësi i vijës së parë dhe më pas tek Shefi i Sektorit të Hetimeve konform Procedurës Standarde të Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit).*
11. *IPK-ja i rekomandon Zyrtarit të Dhomës së dëshmive, që të respektojë rregullat mbi paketimin e dëshmive të konfiskuara në materiale adekuate, varësisht prej specifikave të tyre.*
12. *IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër, që në Dhomën e dëshmive të ushtrohen kontrole përmes inspektimeve të paparalajmëruara dhe inventarizimet, drejt administrimit të duhur të dëshmive.*
13. *IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër dhe Shefit të Resurseve, që të ushtrojnë kontrole të paparalajmëruara lidhur me kontrollin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve.*

Faktet kyçe



Trendi i krimit (2023)

Numri i veprave penale për polic (2023)

Zbulueshmëria e veprave penale (2023)

Prishtinë (Q) Stacionet

-10.3%

-2.6%

11.2

7.6

62.6%

65.3%

Prishtinë (Q)
2022 2024

13.2 m

14.5 m

74:26

66:34



Koha e përgjithshme e reagimit në thirrje

% e reagimit me kohë dhe të shtyrë (raporti)

Prishtinë (Q) Stacionet

64.7%

75.3%

2.2

3.5

1.2

1.4

Shkalla e ekzekutimit të urdhëresave (2023)¹

Numri i të arrestuarve për polic (për vit)

Numri i të ndaluarve për polic (për vit)

Prishtinë (Q) Stacionet²

+1.1%

-11.2%

+0.2%

-7.2%

+0.2%

-3.8%



Trendi i patrullimeve në këmbë (2023)

Trendi i patrullimeve me automjet (2023)

Trendi i pikave të kontrollit (2023)

Prishtinë (Q) Stacionet

+13%

-0.9%

93.7

92.1



Trendi i gjobave (2023)

Numri i gjobave për polic (për vit)

Prishtinë (Q) Stacionet

-17.1%

-23.8%

22.9%

46.6%

4.7

2.9



Trendi i informatave inteligjente (2023)

Informatat të përpunuara në raporte inteligjente

Numri i informatave për polic

¹ Mesatarja e përgjithshme mbi shkallën e realizimit të urdhëresave të gjykatave në masën prej 75.4% derivon nga të dhëna statistikore të 31 stacioneve policore, kurse të dhënat e 10 stacioneve tjera nuk kanë qenë të qëndrueshme për arsye teknike, andaj edhe nuk janë marrë parasysh në nxjerrjen e kësaj mesatareje.

² Analiza dhe krahasimi mbi aktivitetet patrulluese ka marrë për bazë indikatorët e stacioneve të kategorisë A.

Gjetjet kryesore:



1. Organizimi dhe burimet njerëzore

1.1. Elementi më i rëndësishëm i organizatës policore janë burimet njerëzore. Duke konsideruar se paraqesin një vlerë qenësore, shtrohet nevoja për organizimin dhe shpërndarjen e mirëfilltë të tyre. Policia e Kosovës është e organizuar bazuar në Ligjin për Policinë dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës. Në Stacionin Policor - Prishtinë Qendër, IPK ka pasur në fokus organizimin e brendshëm, bazuar në Strukturën organizative të aprovuar me datën 10.07.2023. Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (neni 31), sistemimi dhe transferi i personelit policor, në vendet e detyrat dhe punës, duhet t'iu përshtatet nevojave operacionale, si dhe Strukturës organizative të Policisë. Kurse, neni 29 i Rregullores për Personel dhe Administratë përcakton që zyrtarët policor, detyrat e përgjegjësitë të ushtrojnë bazuar në përshkrime të vendeve të punës për pozitën, në të cilat janë emëruar. Në Stacionin Policor të Prishtinë Qendër është hasur një (1) rast kur pozita ushtrohet nga punonjës me gradë jo adekuate³. Pozita e Shefit të Sektorit të Operativës ushtrohet nga një (1) Toger (PK7503), pozitë që parashihet të mbahet nga punonjës me gradë Kapiten.

1.2. Sipas nenit 37 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2021, kur nevojat e shërbimit kërkojnë plotësimin e një vendi të lirë, me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, përkohësisht caktohet ushtruesi i detyrës. Gjatë inspektimit nuk janë hasur raste që pozitën në kuadër të Strukturës të ushtrohen me ushtrues detyre.

1.3. Siç u potencua në paragrafin 1.1, sistemimi i personelit në vende të punës duhet t'iu përshtatet nevojave dhe Strukturës organizative. IPK-ja është interesuar të njihet nëse në Stacion ka filluar procesi i ri-organizimit dhe ri-sistemimit të personelit. Sa i përket organizimit të brendshëm në kuadër të Stacionit, të gjitha njësitë e parapara me Strukturë janë funksionalizuar. Ri-sistemimi i personelit në kuadër të Strukturës së re organizative është në zbatim e sipër. Në kohën kur është realizuar ky inspektim, ka qenë në proces sistemimi i personelit sipas LPA-së, bazuar edhe në vendimet e reja të punës. Inspektimi vë në pah se pas ri-sistemimit të bazuar në Strukturën e re të organizimit, në tre (3) ekipet patrulluese të Sektorit të Operativës (A, B, C) ka një mbivendosje policësh, meqë parashihet që ato t'i kenë nga 28 polic, por që në fakt ato i kanë nga 36, 39 dhe 38 zyrtarë policor. Edhe te Sektori B është i sistemuar një (1) polic më shumë. Në Zyrën e Personelit dhe Administratës ka shërbyes civil tepër që konsiderohen ende të pa sistemuar.

1.4. Është analizuar gjendja sasiore e burimeve njerëzore, duke i krahasuar me ato që i parasheh Struktura. Deri në fund të vitit 2023, Stacioni nuk kishte funksionalizuar Strukturën e re dhe bazuar në atë të datës 28.02.2019 që ishte aktuale në fund vit, më 31.12.2023, Stacioni ka pasur 178 punonjës (172 të uniformuar dhe 6 shërbyes civil), numër ky më i lartë se që kishte paraparë Struktura (28.02.2019) me 175 punonjës. Me Strukturën e re të datës 10.07.2023, Stacioni ka pësuar një ndryshim strukturor, ku Sektori i Hetimeve është bartur në kuadër të Drejtorisë së Policisë së Kryeqytetit. Tashmë Stacioni ka 139 punonjës, nga të cilët, 134 të uniformuar dhe pesë (5) shërbyes civil. Stacioni ka një gjendje sasiore me burime njerëzore mbi planifikimet dhe në disharmoni me LPA-në dhe Strukturën, që parasheh gjithsej 115 punonjës, prej tyre 111 zyrtarë të uniformuar dhe katër (4) shërbyes civil. Sa i përket numrit të përgjithshëm të personelit, Stacioni tashmë ka një numër të rritur të personelit në masën +20.9% (24 punonjës më tepër). Ky ndryshim përcillet me mospërputhje të numrit të punonjësve nëpër njësi, në raport me numrin e lejuar. Sa i përket strukturës së të graduarve, Stacioni ka një (1) kapiten më pak, katër (4) rreshterë më pak, njëzetë e tetë (28) policë më shumë dhe një (1) shërbyes civil më shumë.

³ Vendimi nr. 10/11-01SAP-P/3975, datë 09.03.2024.

Tabela 1- Burimet njerëzore të Stacionit Policor - Prishtinë Qendër (20.03.2024)							
Kapaciteti (grada)	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Zyrtar policor	Shërbyes civil	Gjithsej
LPA	1	2	3	8	97	4	115
Aktual	1	1	3	4	125	5	139
Gjendja	0	-1	0	-4	+28	+1	+24

1.5. Sipas Rregullores, punonjësi i policisë duhet të paraqitet në detyrë në kohën dhe vendin e caktuar, në detyrat që i janë caktuar me orar paraprak, apo kur kërkohet intervenim i menjëhershëm⁴. Udhëzimi Administrativ mbi Marrëdhënien e Punës në nenin 57 përcakton se punonjësit e punësuar në Polici duhet të vijnë në punë dhe të dalin nga puna me kohë dhe të shkojnë për drekë në kohën e përcaktuar. IPK ka monitoruar vijueshmërinë, si dhe prezencën në punë të personelit gjatë ndërrimit të natës 23.00-07.00 (B), ndërrimit të paradites 07.00-15.00 (A) dhe në orar të rregullt 08.00-16.00 (menaxhmenti, Sektorët, një pjesë e Operativës dhe Administrata). IPK ka krahasuar prezencën fizike të personelit me oraret, në mungesë të regjistrave të vijueshmërisë. Sipas mbikëqyrësve të ndërrimit fillimisht verifikohet ardhja në punë e personelit, konfirmohen mungesat dhe më pas hartohet Orari, duke nënkuptuar se Regjistri i vijueshmërisë nuk mbahet, por që evidencë mbetet Orari. Në ditën e inspektimit, evidenca mbi vijueshmërinë sipas Orarit është përputhur me prezencën fizike të personelit. Vijueshmëria monitorohet nga menaxhmenti dhe administrimi realizohet nga Zyra e Personelit dhe Administratës, si dhe Operativa. Kapacitetet e përgjithshme aktive brenda ndërrimeve janë hasur në masën prej 69.2%. Ndërrimet kanë pasur kapacitete aktive sipas kësaj pasqyre:

- Në Orarin e ndërrimit 23.00-07.00 të datës 19/20 mars 2024, kapaciteti aktiv i personelit ka qenë 60.1% (nga 28 zyrtarë të caktuar në ndërrim, në punë kanë qenë 17 zyrtarë, kurse prej 11 zyrtarëve të munguar, 7 nga ta kanë qenë në pushim javor, 3 në pushim vjetor dhe 1 në pushim mjekësor).
- Në Orarin e ndërrimit 07.00-15.00 të datës 20 mars 2024, kapaciteti aktiv i personelit ka qenë 58.1% (nga 31 zyrtarë të caktuar në ndërrim, në punë kanë qenë 18 zyrtarë, kurse prej 13 zyrtarëve të munguar, 8 nga ta kanë qenë në pushim javor, 2 në pushim vjetor dhe 3 në pushim mjekësor).
- Në Orarin e rregullt 08.00-16.00 të datës 20 mars 2024, kapaciteti aktiv i personelit ka qenë 78% (nga 41 punonjës të caktuar në ndërrim, në punë kanë qenë 32 punonjës, kurse nga 9 punonjës të munguar, 3 nga ta kanë qenë në pushim vjetor, 4 në pushim mjekësor dhe 2 në trajnim).
- Janë hasur edhe shtatë (7) zyrtarë tjerë policor duke punuar në orare tjera të angazhuar në plane operative në oraret fleksibile 10.00-18.00 (kapaciteti aktiv i personelit ka qenë 100%).

1.6. Bartja e pajisjeve për zyrtarë policor është rregulluar me Rregullore për Personel dhe Administratë. Neni 145 lidhur me pajisjet e autorizuara (rripi i uniformës dhe pajisjet që vendosen në rrip) rregullon se punonjësit policor, të cilët kanë autorizime policore, derisa janë në uniformë dhe në kryerje të detyrës, duhet t'i bartin pajisjet, për të cilat janë të autorizuar. Lidhur me pajisjet policore janë inspektuar pesë (5) zyrtarë policor⁵ dhe ka rezultuar se ishin pajisur me pistoleta "Glock", me karikatorë dhe municion të nevojshëm të përcaktuar me rregulla. Lidhur me prangat nuk janë hasur parregullsi apo mungesa. Njëri nga zyrtarët e inspektuar nuk ka pasur me vete shufrën. Po ashtu, njëri nga ta nuk ka qenë fare i pajisur me sprej. Dy prej tyre nuk ishin të pajisur me radio lidhje. Sipas një inspektimi të realizuar nga menaxhmenti i Stacionit në muajin janar të këtij viti, nga numri prej 141 zyrtarëve të inspektuar, me

⁴ Neni 15 i Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës.

⁵ ID-0521, ID-4010, ID-10582, ID-11017 dhe ID-11856.

sprej nuk kanë qenë të pajisur zyrtarët policor të gjeneratës 57 dhe 58, pesë (5) zyrtarë policor nuk kanë pasur jelekë anti - plumb, tre (3) të tjerë nuk kanë pasur bateri për ndriçim, 38 nuk kanë pasur radio lidhje, kurse nuk janë raportuar mungesa të prangave dhe shufrave metalike. Rregullorja përcakton bartjen e pajisjeve dhe Stacioni duhet siguruar që zyrtarët t'i kenë me vete ato, dhe kur ka mungesë të tyre, të sigurohen nga logjistika.

1.7. Veç pajisjeve, IPK ka verifikuar respektimin edhe të standardit të uniformës së zyrtarëve policor. Neni 139 i Rregullores për Personel dhe Administratë përcakton si duhet bartur dhe çka përmban uniforma verore dhe dimërore (klasa A dhe B). Pas inspektimit të veshjes tek pesë (5) zyrtarët, ka rezultuar se përgjithësisht standardi i veshjes ka qenë duke u respektuar, me përjashtim të distinktivit zyrtar, i cili është hasur i vendosur vetëm në uniformën e njërit prej pesë (5) zyrtarëve të inspektuar.

1.8. Dukja personale e zyrtarëve policor është element ndikues meqë përçon imazhin e tyre tek qytetarët. Rregullat mbi dukjen personale janë pasqyruar në nenin 148 të Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës. Standardi i cili është përcaktuar me Rregullore del të jetë respektuar në mënyrë të kënaqshme nga zyrtarët policor të inspektuar në Stacion. Standardi në fjalë është respektuar edhe nga zyrtarët tjerë, të cilët janë hasur gjatë inspektimit.

1.9. IPK në të kaluarën ka rekomanduar që të ushtrohen në vazhdimësi inspektime (kontrolle) të armëve, municioneve, pajisjeve, dhe të hartohen raporte përkatëse, me qëllim që të avancohen standardet unike të punës në menaxhimin efikas dhe efektiv të burimeve. Në Stacion janë siguruar raporte të inspektimeve të realizuara nga drejtuesit dhe mbikëqyrësit. Gjetjet tregojnë se inspektimet organizohen në baza të rregullta mujore, gjashtë mujore, dhe zakonisht ato realizohen nga shefat e njësisve, por për të shtuar kontrollin dhe sigurinë, ato realizohen edhe nga menaxherët më të lartë të Stacionit. Mbi realizimin e inspektimeve të armëve, municionit dhe pajisjeve policore mbahen shënime dhe përpilohen raporte⁶.

1.10. Rregullorja për Operativë në Policinë e Kosovës përcakton që zyrtari policor duhet të përkujdeset që armën zyrtare ta mbajë dhe mirëmbajë në gjendje të rregullt. Zyrtari policor, pa marrë parasysh a është në kryerje të detyrës, apo jo, obligohet që armën zyrtare ta mbajë të pastër dhe në gjendje të rregullt për përdorim. IPK-ja ka inspektuar pesë (5) zyrtarë policor, për të parë nëse kujdesen dhe mirëmbajnë armët dhe pajisjet, përfshirë dhe municionin. Pistoletat kanë rezultuar të pastra, municioni i ndërruar dhe zyrtar, ndërsa spreji për shkak të skadimit të afatit ishte i dorëzuar. Dy (2) nga katër (4) zyrtarët e pajisur me jelekë anti-plumb i kanë pasur këto pajisje pa afat, ose të prishur. Sa i përket sprejit duhet pasur parasysh se përdorimi eventual i atyre me afat të skaduar mund të ndikoj në shëndetin e personave, me të cilët mund të ketë ballafaqim.

1.11. Bazuar në nenin 100 të Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, përcaktohet që njësitë organizative në kuadër të Policisë, divizionet, drejtoritë në Departamentin për Shërbime Mbështetëse, Drejtoritë Rajonale duhet të përkujdesen që secili zyrtar policor i kësaj drejtorie, brenda periudhës kohore prej një (1) viti t'i mbajë së paku 40 orë trajnim (përfshirë edhe certifikimin). Bazuar në të dhënat e siguruar, pasqyrohet ngecje në përmbushjen e numrit të orëve në këtë program trajnimi, si rezultat i lëvizjeve të personelit, angazhimit në plane operative, trajnimeve të tjera, pushimeve, lëndimeve në detyrë, suspendimeve, etj. Baza e të dhënave të Stacionit lidhur me trajnimet e brendshme për vitin 2022 ka përmbledhur

⁶ Raport mujor i inspektimit të armëve dhe municionit (7 dhjetor 2023), Raport mujor i inspektimit të armëve dhe municionit (5 shkurt 2024), Raport mujor i inspektimit të armëve dhe municionit (11 mars 2024), Raport gjashtë mujor i inspektimit të pajisjeve policore (10 janar 2024), etj.

	<p>vijueshmërinë e personelit edhe në Kursin të ri-certifikimit, duke u konsideruar jo e duhur, por që kjo është sanuar në vitin 2023. Lidhur me trajnimet dhe avancimin profesional të zyrtarëve policor të Stacionit, vihet re se:</p> <p>(a) Gjatë vitit 2022, nga 6.080 orë të parapara për 152 zyrtarë të uniformuar, janë realizuar 2.872 orë trajnuese brenda regjionit (47.2%).</p> <p>(b) Gjatë vitit 2023, nga 6.880 orë të parapara për 172 zyrtarë të uniformuar, janë realizuar 4.976 orë trajnuese brenda regjionit (72.3%).</p> <p>1.12. Rregullorja në nenin 114 parasheh që gjithë zyrtarët policor, pa marrë parasysh nivelin dhe gradën policore, janë të obliguar që brenda periudhës kohore prej çdo 12 deri në 18 muaj ta vijnë trajnimin për ri-certifikim⁷. Ri-certifikimi ka për qëllim që të gjithë zyrtarët policorë, përmes këtij procesi t'i ri përsërisin dhe t'i rifreskojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre, në mënyrë që të jenë sa më efikas dhe profesional në kryerjen e punëve policore. Nga të dhënat e siguruar nga Sektori i Resurseve, në 18 muajt e fundit, Ri-certifikimin nga radhët e personelit të uniformuar e kanë vijuar 124 nga 165 zyrtarë policor sa ka Stacioni (75.2%).</p> <p>1.13. IPK ka verifikuar nëse struktura hetimore e Stacionit është e pajisur me njohuri të nevojshme përmes programeve trajnuese/kurseve. Andaj, punonjësit e angazhuar në Sektorin e Hetimeve duhet të kenë kryer Kursin Bazik të Hetimit. Nga inspektimi rezulton se jo të gjithë zyrtarët në Sektorin e Hetimeve kanë kryer Kursin Themelor të Hetimit. Nga 32 zyrtarë policor të caktuar në këtë Sektor, dy (2) prej tyre nuk e kanë të kryer Kursin Bazik të Hetimeve. PSO-Parandalimi dhe Trajtimi i Dhunës në Familje (kapitulli V, pika h) parasheh që çdo pjesëtar i policisë që trajton raste të dhunës në familje duhet të jetë i trajnuar, apo të ndjekë trajnimin adekuat profesional të organizuar nga Departamenti i Trajnimit/institucione, apo organizata tjera. Nga katër (4) hetuesit e caktuar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, vetëm njëri nga ta nuk e ka të kryer kursin përkatës për hetimin e rasteve (edhe Mbikëqyrësi i Ekipit për Dhunë në Familje nuk ka kryer këtë kurs). Zyrtari i Dhomës së dëshmive ka kryer Kursin Bazik të Hetimeve dhe atë për Dhomën e dëshmive. PSO-Teknika Kriminallistike (Sektori i Vendit të Ngjarjes) parasheh që me qëllim krijimi të një kriteri për trajnim për teknikë kriminallistike nevojiten standardet e nevojshme që do t'i plotësojnë teknikët kriminallist, të cilët punojnë në teknikë kriminallistike në tre (3) nivelet. Sipas kësaj, teknikët kriminallist që punojnë në stacione në kuadër të Ekipit të vendit të ngjarjes, me qëllim të plotësimit të kërkesave të njësisë, preferohet të jenë të certifikuar në trajnimet: Kursi Bazik për Teknik Kriminallist dhe Kursi Bazik i Hetimit. Sipas kriterit të parë, katër (4) hetues nga Ekipi i Teknikës Kriminallistike kanë kryer kurs përkatës për këtë fushë, dhe vetëm një (1) nuk e ka të kryer. Të gjithë zyrtarët e caktuar në këtë njësi e kanë të kryer Kursin Bazik të Hetimeve.</p> <p>1.14. Bazuar në rregullat në fuqi, stacionet trajtojnë shkeljet e lehta disiplinore që u drejtohen nga autoriteti kompetent policor (DSP-ja). Kjo fushë është rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2019 për Shkeljet, Masat e Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës dhe PSO për Procedurën Disiplinore në Nivel Lokal (DPPK-01-PSO-01). Bazuar në nenin 13, nëse shkeljet bëjnë pjesë në kategorinë e shkeljeve të lehta disiplinore, hetimet fillojnë dhe përfundojnë në nivel lokal sipas kategorisë</p>
--	---

⁷ Rregullorja për Personel dhe Administratë përcakton që varësisht nga niveli, apo grada e zyrtarit policor kryhet dhe ricertifikimi. Në kuadër të këtij procesi hyjnë ricertifikimet, që nuk kufizohen vetëm në: përdorimin-gjuajtjen me armë të zjarrit, ndalimin dhe kontrollimin e automjeteve dhe mjeteve tjera motorike, kontrollimin e turmave, taktikat mbrojtëse, ndihmën e parë, Kodin e mirësjelljes, informimin me aktet e reja normative, afësimin në komunikim, planifikimin operativ e taktik, menaxhimin dhe lidhshimin, menaxhimin e stresit/konfliktit/incidentit kritik, përpilimin e raportit, zgjidhjen e problemit, marrjen e vendimit, këshillimin e monitorimin, Policinë në Komunitet, raportin Polici-media, vlerësimin e performancës.

së shkeljeve të lehta. IPK ka siguruar tre (3) raste të trajtuar nga autoriteti hetues në nivel stacioni⁸, ku janë vlerësuar nga aspekti i respektimit të rregullave-procedurave konform aktit për shkeljet e lehta disiplinore. Sa i përket epilogut të tyre, të tre lëndët janë mbyllur në nivel stacioni në mungesë provash për shkelje të lehta, dhe në asnjë rast të dyshuarit nuk janë shpallur fajtor. Afatet e trajtimit dhe kompetenca lëndore e hetimit lidhur me këto mostra janë respektuar konform Udhëzimit⁹ dhe PSO-së. Mostrat përmbajnë njoftimet për palët, vendimet, deklaratat, raportet përfundimtare.

1.15. Për kryerjen e detyrave gjatë punës, menaxherët dhe drejtuesit janë të detyruar të vlerësojnë rezultatet në punë, të njohur si vlerësim performance. Bazuar në nenin 79 të Udhëzimit Administrativ mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, punonjësit e policisë lidhur me kryerjen e detyrave të punës i nënshtrohen vlerësimit periodik të performancës që ka për qëllim rritjen e cilësisë në punë dhe përmirësimin apo avancimin gradual të aftësisë profesionale të punonjësit. Sipas PSO-së, Policia, respektivisht mbikëqyrësi ku punonjësi punon, është i obliguar që së paku një herë në vit ta bëjë vlerësimin e performancës për punonjësin, që është nën mbikëqyrjen e tij. Lidhur me këtë, IPK-ja ka marrë pesë (5) mostra të vlerësimit të performancës (1 toger, 2 rreshterë dhe 2 zyrtarë policor)¹⁰. Vlerësimi i i tyre i performancës është bërë në formular standard dhe është realizuar brenda afatit kohor. Nga vlerësimet e siguruar nuk është hasur ndonjë pa kënaqësi apo ankesë kundrejt tyre.

2. Aktivitetet operative

2.1. Në Raportin e inspektimit “Menaxhimi i thirrjeve dhe reagimit policor”, i dalur nga inspektimi i realizuar në të gjitha stacionet është pasqyruar se janë hasur dobësi në mbajtjen e logut operacional¹¹, andaj IPK-ja u ka rekomanduar komandantëve të stacioneve, shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve, që të ushtrojnë kontrole të shtuara përfshirë dhe auditime të planifikuara periodike mbi zyrtarët që mbajnë logjet, drejt ngritjes së cilësisë së evidencës. IPK-ja ka siguruar Logun e tre muajve të fundit (janar, shkurt, mars), për t’u siguruar nëse evidencia është cilësore dhe e përditësuar. Deri më 16.03.2024, Logu operacional është mbajtur nga Baza e radio komunikimit të Stacionit, kurse pas kësaj date ka filluar të administrohet dhe mbikëqyret nga niveli rajonal (QOKR- Prishtinë). Për dallim nga inspektimi i kaluar vërehet se ka përmirësim në evidencën e Logut, por që nuk është e mjaftueshme. Inspektimi vë në pah se për thirrjet dhe reagimin mbahet evidencë, që ka nevojë të sigurojë të dhëna më të azhuruara, meqë thirrjeve në shumë raste nuk iu është pasqyruar koha e arritjes së njësisve policore në vendngjarje.

2.2. PSO përcakton që koha e reagimit për zonat urbane të jetë maksimum 15 minuta dhe për zonën rurale maksimum 30 minuta, varësisht lokacionit ku ndodhë rasti (me përjashtim në disa zona të thella malore e me kushte të papërshtatshme atmosferike). IPK ka pasur fokus reagimin policor në thirrjet e qytetarëve dhe për të konstatuar efektivitetin e njësisve policore, janë kontrolluar 1.213 mostra të ngjarjeve ku ka pasur reagim¹². Nga analiza e mostrave të thirrjeve rezultojnë këta indikatorë:

(a) Në vitin 2024, koha e përgjithshme e reagimit të stacionit në thirrjet e qytetarëve është zgjatur për 1.3 minutë, nga 13.2 në 14.5 minuta (koha e përgjithshme

⁸ Dosjet nr. 0383-HBNL-2022, 0157-HBNL-2023 dhe 0251-HBNL-2023.

⁹ Neni 69, paragrafi 12 i Udhëzimit.

¹⁰ Raportet e vlerësimit të performancës me nr. PK5357, PK5018, PK6939, PK7887 dhe PK10891.


¹¹ Logu është pasqyrë e krijuar elektronike, a me shkrim, ku evidentohen informimet telefonike zyrtare të pranuar nga cilido informues i mundshëm, për një ngjarje të caktuar të ndodhur më parë, apo që është në zhvillim e sipër.

¹² Koha e reagimit llogaritet nga pranimi i informatës nga QOKR-ja, mbikëqyrësi, apo Policia në ndonjërin nga format e komunikimit, koha e dhënies së informatës tek patrulla apo njësi që ngarkohet, koha e nisjes së patrullës/njësisë së ngarkuar dhe arritja në vendngjarje.

mesatare e reagimit për gjithë stacionet në vitin 2022 ka qenë 13.76 minuta). IPK vëren se edhe ndarja e shtyrë e detyrës pas prioritetizimit të thirrjeve dhe i bazuar në kapacitetet e stacionit, ndikon në zgjatjen e kohës së përgjithshme të reagimit të njësisive në vendngjarje.

- (b) Raporti në përqindje ndërmjet reagimit me kohë dhe reagimit me vonesë është 66:34, i ndryshëm me raportin nga viti 2022 që ishte 74:26 (ky raport në nivel të të gjitha stacioneve në matjet e vitit 2022 ka qenë 80:20).
- (c) Krahasuar me vitin 2022, në vitin 2024 ka një përmirësim të kohës reagimit në thirrjet e tipit “vepra penale” për 0.68 minuta dhe “tjera” për 1.1 minutë, derisa ka zgjatje të kohës së reagimit për thirrjet e tipit “aksident” për 3.5 minuta, “incident” për 1.76 minuta dhe “komunikacion” për 1.96 minuta.

Diagrami 1 - Reagimi policor sipas tipit të thirrjes (minutazha)



2.3. Bazuar në nenet 29, 30, 31 dhe 32 të Rregullores për Personel dhe Administratë, policët, rreshterët, togerët, si dhe kapitenët kanë përgjegjësi të raportimit, varësisht pozitive menaxhuese. IPK ka verifikuar nëse zyrtarët e Stacionit kryejnë raportimet e nevojshme sipas detyrave të parapara dhe nëse ato kryhen me kohë. Fillimisht janë siguruar raportet e patrullave mbi ngjarjet në ndërrimet e fundit, ku janë përfshirë fletë patrullat e tre (3) ndërrimeve të tre (3) ditëve të fundit (13, 14 e 15 mars) dhe Raporti 24 orë i situatës ditore i datës 18 dhe 19 mars. Për aktivitetet ditore, zyrtarët policor hartojnë raportet për detyrat e realizuara të ndërrimit (fletë patrulla), që inspektohen nga mbikëqyrësit dhe bëhen pjesë e Raportit 24 orë në nivel Stacioni. Katër (4) nga njëzetë e një (21) fletë patrulluese janë hasur të panëshkruara nga Udhëheqësi i Ndërrimit¹³ dhe tetë (8) sosh pa data të angazhimit ditor¹⁴. Sa i përket raportimeve nga ana e sektorëve (Operativa, Hetimet dhe Resurset), ato raportojnë periodikisht dhe informatat i përmbledhin në raporte vjetore të Stacionit.

2.4. IPK ka përcjellë rrugëtimin e rasteve deri te njësitë kompetente që vazhdojnë me trajtimin e tyre. Është detyrë e njësitit patrullues të kompletojë rastin e raportuar brenda zonës së përgjegjësisë dhe më pas t’ia dorëzoj Shefit të ndërrimit për kontroll dhe nënshkrim. Rasti duhet të dorëzohet nga njësiti i patrullës sa më parë që është e mundur dhe më së voni deri në përfundimin e orarit të punës. Rasti regjistrohë në Librin e rasteve në Zyrën e Bazës së Stacionit (në mënyrë elektronike dhe fizike). Përveç rasteve urgjente, rastet që iniciohen brenda 24 orëve (brenda tre ndërrimeve), çdo ditë (përfshirë vikendit dhe festave) në orën 08.30 të mëngjesit dorëzohen në Operativë, të cilat kontrollohen nga Shefi i Operativës se a janë kompletuar sipas procedurave të parapara dhe a janë në pajtim me KPRK, KPP e ligjet tjera në fuqi. Nëse rasti është i kompletuar, i dërgohet Komandantit apo zëvendësuesit të tij për

¹³ Fletë patrullat: Orari i datës .../AC101/Koha e punës .../Ekipi A, Orari i datës 14.03.2024, AC102/Koha e punës 15:00-23:00/Ekipi A, Orari i datës 14.03.2024, AC103/Koha e punës 15:00-23:00/Ekipi A dhe Orari i datës 14.03.2024, AC301/Koha e punës 23:00-07:00/Ekipi C.

¹⁴ Fletë patrullat: AC102/Koha e punës 15:00-23:00/Ekipi A, AC201/Koha e punës 07:00-15:00/Ekipi B, AC101/Koha e punës 15:00-23:00/Ekipi A, AC206/Koha e punës 07:00-15:00/Ekipi B, AC203/Koha e punës 07:00-15:00/Ekipi B, AC201/Koha e punës 07:00-15:00/Ekipi B, AC202/Koha e punës 15:00-23:00/Ekipi B dhe AC203/Koha e punës 07:00-15:00/Ekipi B.

nënshkrim. Pas nënshkrimit, rastet merren nga Zyrtari i SIPK, fotokopjohen dhe një kopje mbetet në arkiv (data bazë), kurse origjinali i dërgohet Njësisë së Hetimeve jo më vonë se në orën 09.00 për çdo ditë pune. Lidhur me procedimin e rasteve janë inspektuar pesë (5) mostra me Raport fillestar të incidentit¹⁵ dhe rezultojnë se të gjitha janë regjistruar në Librin e rasteve, janë pranuar dhe kompletuar nga Operativa me kohë. Mostrat janë hasur të nënshkruara nga oficeri, mbikëqyrësi dhe Komandanti i stacionit, janë regjistruar në SIPK dhe janë shpërndarë tek njësitë përkatëse.

2.5. Patrullimet janë aktivitete që realizojnë stacionet, në drejtim të krijimit të një mjedisi të sigurt për qytetarët. Sipas nenit 3 të Rregullores për Operativë, patrullimi është veprim policor, përmes të cilit mbahet rendi e qetësia publike, sigurohet prona, lëvizja e lirë, kontrolli i kufirit, rregullimi i trafikut, parandalimi e zbulimi i veprave penale, kapja e kryesve të veprave penale, si dhe veprime e aktivitete tjera nga fusha e sigurisë, të cilat bëhen nga Policia në zbatim të ligjit. IPK ka verifikuar prezencën e patrullave në orët e hershme të mëngjesit, para dorëzimit të ndërrimit 23.00-07.00. Është siguruar Orari ditor i angazhimit të patrullave dhe me ndihmën e Mbikëqyrësit të ndërrimit (ID-5357) janë verifikuar lokacionet e patrullave në terren. Në mëngjesin e datës 20.03.2024, patrullat janë hasur në përbërje të plotë dhe në thirrje, varësisht kërkesave, të angazhuara në katër (4) njësi me pjesëtarë të ekipeve patrulluese, me nga dy (2) e tre (3) polic secila, me katër (4) automjete, gjë që e dëshmojnë edhe fletë patrullat. Patrullat kanë qenë duke zhvilluar aktivitete në lokacionet si në tabelë.

Patrulla	Thirrja	Automjeti	Sektori	Lokacioni	Aktiviteti
I	AC201	555-01	I	Rr. UÇK	Patrullim
II	AC202	191-03	II	Rr. Luan Haradinaj	Pikë kontroll
III	AC203	218-03	III	Rr. B	Në rast
IV	AC204	093-03	IV	Rr. Ibrahim Lutfiu	Patrullim

2.6. Patrullat kryejnë patrullime me automjete (PA) dhe patrullime në këmbë (PK), por organizojnë edhe pika të kontrollit të automjeteve (PKA). Neni 10 i Rregullores për Operativë përcakton që ndalja e automjetit për shkak të kundërvajtjes në trafik, apo për qëllime tjera, në të shumtën e rasteve konsiderohet si detyrë e rregullt e zyrtarëve policor patrullues. Realizimi i patrullimeve dhe pikë kontrolleve varet nga një sërë faktorësh dhe nuk ka metodologji të caktuar se si duhet kombinuar këto aktivitete. Nga analiza e aktiviteteve ka rezultuar se numri prej pesë (5) patrullave të një ndërrimi tetë (8) orë është në nivel me mesataren për 13 stacionet policore të kategorisë A. Bie në sy raporti ndërmjet numrit të PK-ve dhe PA-ve, raport ky i dallueshëm me atë për 13 stacione të kategorisë A. Stacioni organizon pothuajse numër të njëjtë të PK-ve dhe PA-ve, derisa parametrat për 13 stacionet pasqyrojnë se ato gjatë një ndërrimi realizojnë më tepër PA se PK. Stacioni duhet të analizojë këta tregues, për t'u siguruar se kjo metodologji praktikohet për shkak të patrullimit më të lehtë në zonë urbane, apo nëse ka nevojë për më tepër automjete. Edhe indikatorët tregojnë se PKA-të nuk janë të mjaftueshme brenda një patrullimi, shifrat pasqyrojnë se patrullat e Stacionit brenda një patrullimi realizojnë 1.2 pika kontrolli, derisa kjo mesatare për 13 stacione të kategorisë A është më e ulët (rreth 1.0 pika kontrolli).

Indikatorët	Prishtinë Qendër		Stacionet (kategoria A)	
	2022	2023	2022	2023
Patrulla për vit	5.535	5.569	82.259	71.978
Patrulla për ditë	15	15	17	15
Patrulla për ndërrim	5	5	6	5
Raporti në % (PK/PA)	47/53	47/53	37/63	38/62

¹⁵ 2024-AB-704, 2024-AB-705, 2024-AB-706, 2024-AB-707 dhe 2024-AB-708.

Tabela nr. 4 - Pikat e kontrollit të automjeteve (PKA) gjatë patrullimeve (PA)				
Indikatorët	Prishtinë Qendër		Stacionet (kategoria A)	
	2022	2023	2022	2023
Pika kontrolli për vit	3.452	3.460	47.216	44.763
Patrulla me automjet	2.920	2.926	51.634	44.794
Pika brenda një patrullimi	1.2	1.2	0.9	1.0

2.7. Analiza e indikatorëve të performancës së Stacionit Policor - Prishtinë Qendër për vitin 2023, rezulton se:

- Ka ngritje të ndjeshme numrit të PK-ve për +1.1% krahasuar me vitin paraprak, përkundër që këto kanë rënie për -11.2% në nivel të 13 stacioneve policore të kategorisë A. Realizimi mesatar ditor prej 7.24 patrullime renditë Stacionin në nivel mbi mesataren e përgjithshme të stacioneve të kategorisë A që është 5.72 patrullime ditore (26.6% më lartë),
- Ka pasur numër të balancuar të PA-ve krahasuar me vitin paraprak, përkundër që këto kanë rënie për -7.2% në nivel të 13 stacioneve të kategorisë A. Realizimi mesatar ditor prej 8.0 patrullime renditë Stacionin në nivel nën mesataren e stacioneve që është 9.44 patrullime (15.3% më ulët),
- Ka pasur numër të balancuar të PKA-ve krahasuar me vitin paraprak, përkundër që këto kanë rënie për -3.8% në nivel të 13 stacioneve të kategorisë A. Realizimi mesatar ditor prej 9.48 pika kontrolli renditë Stacionin në nivel me mesataren e përgjithshme që është 9.43 pika të kontrollit.

Tabela nr. 5 - Të dhëna mbi PK-të dhe krahasimi në raport me mesataren e përgjithshme të derivuar për stacionet e kategorisë A							
Stacioni	Viti 2022		Viti 2023		Trendi	Raporti me mesataren	
	Numri	Në ditë	Numri	Në ditë		2022	2023
						Prishtinë Q.	2.615
13 stacione (A)	30.625	6,45	27.184	5,72	-11.2%		

Tabela nr. 6 - Të dhëna mbi PA-të dhe krahasimi në raport me mesataren e përgjithshme të derivuar për stacionet e kategorisë A							
Stacioni	Viti 2022		Viti 2023		Trendi	Raporti me mesataren	
	Numri	Në ditë	Numri	Në ditë		2022	2023
						Prishtinë Q.	2.920
13 stacione (A)	51.634	10.88	44.794	9.44	-7.2%		

Tabela nr. 7 - Të dhëna mbi PKA-të dhe krahasimi në raport me mesataren e përgjithshme të derivuar për stacionet e kategorisë A							
Stacioni	Viti 2022		Viti 2023		Trendi	Raporti me mesataren	
	Numri	Në ditë	Numri	Në ditë		2022	2023
						Prishtinë Q.	3.452
13 stacione (A)	110.617	9.95	106.382	9.43	-3.8%		

2.8. Në trafik shkaktohen kundërvajtje, për të cilat stacionet shqiptojnë gjoba, në drejtim të ngritjes së sigurisë në rrugë. Duke iu referuar të dhënave statistikore për Stacionin, gjobat në trafik janë shtuar dhe numri i tyre në vitin 2023 ka shënuar një ngritje për +13%, ku rezulton se një polic i Stacionit ka shqiptuar mesatarisht 93.7 gjoba në vit (mesatarja e përgjithshme për stacionet është 92.1 gjoba për polic gjatë vitit). IPK-ja është interesuar të njihet me funksionimin e SIPK-ut dhe procedurën e evidentimit të kundërvajtësve për shqiptim të masës mbrojtëse, pikëve negative dhe regjistrimin në evidencë fizike. Për dhjetë (10) mostra të kundërvajtjeve është gjetur


se gjobat janë shqiptuar të plota konform Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor. Masat mbrojtëse, pikët negative dhe gjobat janë evidentuar në SIPK dhe për to praktikohet evidencë fizike. Sa i përket rregullave mbi konfiskimin e patentë shoferëve me masë mbrojtëse dhe pikë negative, inspektimi vë në pah se nga dhjetë (10) rastet e kontrolluara¹⁶, patentë shoferët e konfiskuar nuk kanë të bashkëngjitur Vërtetimin mbi konfiskimin, të paraparë me nenin 17, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 05/2023 për Procedurat e Kundërvajtjes. Në dy (2) prej dhjetë (10) rasteve të inspektuara, që janë përcjell me konfiskim të patentë shoferëve, tek kundërvajtësit është testuar prezenca e alkoolit konform nenit 245 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, por që në njërin prej tyre nuk është lëshuar Procesverbal i ekzaminimit të pranisë së alkoolit, drogave apo barnave në organizëm¹⁷.

Tabela nr. 8 - Të dhëna mbi gjobat për kundërvajtjet në trafik dhe krahasimi në raport me mesataren e përgjithshme për polic

Stacioni	Viti 2022		Viti 2023		Trendi	Raporti me mesataren për polic	
	Numri	Për polic	Numri	Për polic		2022	2023
Prishtinë Q.	14.254	93.8	16.114	93.7	+13%	-4.1	+1.6
37 stacione	283.970	97.9	281.395	92.1	-0.9%		

2.9. Puna policore në masë të madhe lidhet me parandalimin, hetimin e zbulimin e krimit, andaj Policia ndërmerr veprime hetimore dhe masa të nevojshme që të zbuloj veprat penale dhe të kapë kryesit e tyre. Po ashtu, Policia vepron edhe në realizimin e urdhëresave të gjykatave dhe organet e drejtësisë e ngarkojnë atë që të sjellë para tyre të dyshuarit/të dënuarit, që mund të lidhen me vepra të ndryshme penale, apo për kundërvajtje. IPK-ja ka pasqyruar të dhënat nga raportet statistikore rajonale për vitin përkatës dhe krahasimet janë bazuar në raporte të tilla. Stacioni angazhohet në ekzekutimin e urdhëresave të gjykatave dhe analiza e indikatorëve të performances pasqyron se:

- (a) Në tre vitet e fundit ka pasur shkallë më të ulët të ekzekutimit të urdhëresave në krahasim me mesataren e përgjithshme për stacionet. Në vitin e fundit, kuota e realizimit të urdhëresave arrin në masën prej 64.7%, kuotë kjo që është nën nivel të mesatares së përgjithshme të stacioneve (75.3%).




- (b) Për dallim nga viti 2021, kur Stacioni ka pasur shkallë të lartë të urdhëresave të parashkruara, në vitet e fundit pasqyrohet një shkallë më e ulët, apo në nivel me mesataren e përgjithshme për stacionet. Në vitin e fundit, kuota e urdhëresave të parashkruara ka qenë 3.6% e totalit të urdhëresave (mesatarja e përgjithshme e stacioneve është 3.3%),

¹⁶ Mostrat e gjobave për kundërvajtje që kanë rezultuar me konfiskim të patentë shoferëve: DL-31219832, DL-30361746, DL-30365759, DL-31400324, DL-31366447, DL-31367264, DL-30083358, DL-31110017, DL-31461459 dhe DL-30801993.

¹⁷ Mostra e gjobës pa procesverbal të ekzaminimit të pranisë së alkoolit, nr. SHQ5A0003182475K.

Diagrami 3 - Shkalla e urdhëresave të parashkuara (përqindja)



(c) Në dy vitet e fundit, Stacioni ka pasur shkallë të lartë të urdhëresave të mbetura në fund vit dhe të bartura në vitin pasues. Në vitin e fundit, kuota e urdhëresave të bartura në vitin 2024 është 31.7% e totalit të urdhëresave të disponueshme të Stacionit (mesatarja e përgjithshme për stacionet është 21.4%).

Diagrami 4 - Shkalla e urdhëresave të mbetura në fund vit (përqindja)



(d) Sa i përket ngarkesës dhe efikasitetit të realizimit të urdhëresave për polic, një i tillë nga Stacioni Policor Prishtinë Qendër ka ngarkesë me urdhëresa shumë më shumë se sa një polic nga mesatarja e përgjithshme për stacionet tjera policore. Në dy vitet e fundit, një polic i Stacionit është ngarkuar mesatarisht me 12.2, përkatësisht 11.5 urdhëresa, derisa për stacionet kjo mesatare është dukshëm më e ulët. Në vitin 2023, një polic i Stacionit ka realizuar mesatarisht 7.2 nga 11.5 urdhëresa, derisa sipas mesatares së derivuar nga matjet për 30 stacione policore rezultojnë se një polic ka realizuar mesatarisht 5.4 nga 7.5 urdhëresa të ngarkuara.

Tabela nr. 9 - Të dhëna analitike mbi ngarkesën me urdhëresa të gjykatave dhe efektivitetin e realizimit të tyre (për polic)

Stacioni	2021		2022		2023	
	Ngarkesa	Realizimi	Ngarkesa	Realizimi	Ngarkesa	Realizimi
Stacioni	24.8	16.8	12.2	7.1	11.5	7.5
Stacionet	8.1	5.9	7.4	5.6	7.2	5.4

2.10. Në kuadër të detyrave, zyrtarët policor merren me realizimin e urdhëresave të gjykatave për vepra të ndryshme penale, përfshirë urdhëresat për ekzekutim dënimi (me burg), urdhër arreste (365 ditë), letër rreshtime, urdhëresa për kohë të caktuar (për paraqitje në seanca gjyqësore), urdhëresa për mbikëqyrjen e masave të arrestit shtëpiak dhe urdhëresa tjera. Nga dhjetë (10) dosjet e kontrolluara me urdhër arreste në kohë zgjatje 365 ditë dhe letër rreshtime, të cilat janë parashkuar, apo tërhequr nga organi kompetent, IPK është interesuar për veprimet e ndërmarra në realizimin e tyre. Nga dhjetë (10) dosje të kontrolluara¹⁸, inspektimi vë në pah se nga njësitë policore të Stacionit janë ndërmarrë mesatarisht nga 1.8 veprime për secilin rast, në drejtim të realizimit të tyre. Ndërsa, koha mesatare drejt veprimit të parë policor, prej momentit të lëshimit të urdhëresës nga gjykata është 8.3 ditë. IPK inkurajon zyrtarët policor që të ngritin numrin e aktiviteteve në realizimin e urdhëresave dhe të shkurtohet koha fillestare e veprimit të parë në realizimin e urdhëresave. Të gjitha mostrat e inspektuara janë hasur të regjistruara në SIPK.

¹⁸ Mostrat e inspektuara të urdhëresave: P.nr.463/20, PPRKR.nr.378/2022, PM.nr.46/22, PPRKR.nr.107/22, P.nr.2502-21, P.nr.133/21, P.nr.3836/17, P.nr.2998/18, PN.nr.286/17 dhe PPR.nr. 324/2023.

2.11. Në të kaluarën është vërejtur se një numër i stacioneve kanë aplikuar heqjen e urdhër arresteve nga SIPK-u nga momenti kur atyre u skadon afati ligjor, derisa disa tjera, tërheqjen e kanë praktikuar pasi të kenë pranuar shkresa mbi tërheqjen, lëshuar nga organi kompetent. IPK është interesuar për përditësimin, apo shlyerjen me kohë të urdhëresave nga SIPK-u dhe lidhur me këtë janë inspektuar dhjetë (10) mostra, të cilave u kishte kaluar afati 365 nga dita e lëshimit të urdhër arrestit nga gjykata, apo tërheqjen e kanë praktikuar pasi të kenë pranuar shkresa mbi tërheqjen, lëshuar nga organi kompetent. Stacioni Policor Prishtinë Qendër, pas skadimit të afatit 365 ditë të urdhër arresteve, ose të revokimit të tyre, bën shlyerjen me kohë nga SIPK.

2.12. Ligji për Policinë rregullon fushën e përdorimit të forcës dhe armës së zjarrit nga zyrtarët policor, të cilët janë të autorizuar të përdorin forcë, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që kërkohet për t'i arritur objektivat legjitime të Policisë. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 për Përdorimin e Forcës nga Zyrtarët Policor parasheh raportimin e zyrtarit policor në rastet kur ai përdorë forcën fizike. Në vitin 2022 janë raportuar 100 raste të përdorimit të forcës me 223 zyrtarë të përfshirë, kurse në vitin 2023 janë raportuar 47 sosh me 101 zyrtarë të përfshirë. Ka rënë numri i rasteve të raportuar me përdorim force për 53%. Një polic i Stacionit gjatë vitit 2022 ka arrestuar mesatarisht 2.4 dhe ka ndaluar 2.2 persona (mesatarja për stacione është 3.9 të arrestuar dhe 1.5 të ndaluar për polic). Në vitin e fundit, indikatorët kanë trend rënës, ku një polic i Stacionit ka arrestuar mesatarisht 2.2 dhe ka ndaluar 1.2 persona (mesatarja për stacione është 3.5 të arrestuar dhe 1.4 të ndaluar për polic). Në pesë (5) dosjet e inspektuara për përdorim të forcës¹⁹, nga zyrtarët policor të Stacionit Policor të Prishtinë Qendër është bashkëngjitur formulari për përdorim të forcës dhe njoftimet drejtuar Drejtorisë Rajonale, që i janë drejtuar në kompetencë KSHPF për trajtim. Rastet e inspektuara janë trajtuar nga KSHPF, por për tre (3) sosh nuk janë hasur vendimet mbi shqyrtimin nga Komisioni përkatës (05/1-01Q-0006, 05/3-01Q-0032 dhe 05/3-01Q-0050).

Stacioni	2022		2022	
	Të arrestuar për polic	Të ndaluar për polic	Të arrestuar për polic	Të ndaluar për polic
Prishtinë Qendër	2.4	1.4	2.2	1.2
Stacionet (37)	3.9	1.5	3.5	1.4

2.13. SIPK është bazë e të dhënave, ku bëhet verifikimi, regjistrimi, evidentimi i të gjitha rasteve, të cilat lajmërohen në Polici. Palët që kanë nevojë për verifikim të të kaluarës kriminale, mund të parashtrojnë kërkesë në stacione/nënstacione policore më të afërta të vendbanimit, apo vendqëndrimit të parashtruesit të kërkesës, tanimë edhe në platformën qeveritare e-Kosova. PSO - Verifikimi i të Kaluarës Kriminale parasheh që kërkesa, parashtruesi i të cilës nuk ka të kaluar kriminale duhet realizuar brenda 24 orëve, për ditë pune (verifikimi, konfirmimi, plotësimi dhe lëshimi i vërtetimit). Stacioni në vitin 2022 ka pranuar 4.473 kërkesa nga palët për t'u pajisë me vërtetime të kaluarës kriminale, kurse në vitin 2023 ky numër ka arritur në 5.819. Realizimi i kërkesave është në masën prej 86% për vitin 2021 dhe 77% për vitin 2022 (në vitin 2022 janë realizuar 3.846 kërkesa, derisa në vitin 2023 gjithsej 4.476 sosh). IPK ka inspektuar dhjetë (10) mostra për të verifikuar respektimin e afatit për lëshim me kohë të vërtetimeve²⁰. Dhjetë (10) kërkesat (mostrat) e inspektuara kanë rezultuar të përcaktuara ndaj parashtruesve pa të kaluar kriminale, për të cilat, vërtetimet duhet

¹⁹ Mostrat e rasteve të përdorimit të forcës: 05/1-01/Q-0006/23, 05/3-01/Q-0032/23, 05/1-01/Q/0016/23, 05/3-01/Q/0050/2323 dhe 05/1-01/Q/0010/2023.

²⁰ Rastet e inspektuara për verifikim të së kaluarës kriminale: RN-2024-AB-203, RN-2024-AB-208, RN-2024-AB-221, RN-2024-AB-264, RN-2024-AB-265, RN-2024-AB-267, RN-2024-AB-269, RN-2024-AB-271, RN-2024-AB-274 dhe RN-2024-AB-283.

lëshuar brenda dite apo 24 orëve, siç parashihet me rregullore. Sipas personave përgjegjës, e gjithë kjo është rezultat i numrit të madh të kërkesave të paraqitura në formë fizike dhe elektronike përmes platformës e-Kosova.

2.14. Planet janë mjet menaxhimi, që lehtësojnë koordinimin e burimeve (njerëzore, financiare, teknike), që të jetë e mundur të arrihen qëllimet dhe objektivat. Në Polici janë disa nivele të përgatitjes së planeve (qendror, rajonal dhe lokal). IPK-ja është interesuar të njihet me planet që janë hartuar në nivel Stacioni. Nëse u referohemi të dhënave nga raportet statistikore, përgjatë dy (2) viteve të fundit janë nxjerrë 162 përkatësisht 112 plane operative, nga të cilat IPK-ja ka kontrolluar pesë (5) sosh²¹. Për të gjitha mostrat ka pasur proces të analizës dhe vlerësimit, të dokumentuar me Raport pas operacional. Duke iu referuar të dhënave mbi veprat penale më serioze, të pasqyruar në Raportin vjetor të punës (2023), rezulton se në vitin 2023 ka pasur trend të ngritjes së numrit të veprave penale “lëndim i lehtë trupor” për +19% dhe “grabitje” për +183.3%, derisa trend rënës kanë shënuar veprat penale “vjedhje” për -3.3%, “vjedhje e rëndë” për -28.7% dhe “dhunë në familje” për -2.9%. Bazuar në të dhënat e Raportit vjetor (2023) del se janë hartuar plane që adresojnë parandalimin të tyre. Vihet në pah hartimi i planeve operative mbi sigurinë rrugore, ekzekutimin e urdhërësive të gjykatave dhe parandalimin dhe luftimin e veprave penale.

2.15. Fokus i inspektimit ka qenë edhe realizimi i planeve dhe njohja me ato që janë në zbatim. Në ditën kur është realizuar inspektimi, Stacioni sipas Orarit patrullues ka realizuar aktivitete në zbatim të një mori planesh operative lidhur me trafikun dhe parandalimin e luftimin e veprave penale, etj. Lidhur me zbatimin e aktiviteteve patrulluese në funksion të planeve operative, janë kontrolluar tre (3) fletë patrulla të ekipeve patrulluese të ndërrimit 23.00-07.00 të datës 19/20 mars 2024 dhe nga aktiviteti i tyre është hasur se ka pasur aktivitete në përmbushje të planeve në fuqi²².

2.16. PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit përcakton se kur patrulla del në vendin e ngjarjes dhe në bazë të informatave vlerëson se nuk ka elemente të veprës penale apo elemente të kundërvajtjes, atëherë patrulla përpilon Shënim Zyrtar për veprimet e ndërmarra në lidhje me informatën dhe e dërgon në operativën e stacionit përmes zinxhirit komandues. Shënimi Zyrtar me shkresa përcjellëse protokollohet dhe arkivohet në operativë, ndërsa informatat në lidhje me të përcillen tek njësia përkatëse (në sektor policor, Njësinë e Hetimeve, Inteligjencë e Stacionit, “nevoja për të ditur PUI”). Për të parë se sa respektohet PSO, IPK-ja ka kontrolluar dhjetë (10) lëndë²³, me fokus nëse kanë raporte, nëse janë evidentuar sipas rregullave (protokollimi dhe arkivimi), nëse janë trajtuar në mënyrën e duhur, nëse rastet që lidhen me pro-formën ndërlidhen me vepra penale, nëse është konsultuar Prokurori për rastet e tilla dhe nëse ato janë përcjellë te njësitë përkatëse. Kontrolli i lëndëve vë në pah se asnjëra nga to nuk ka qenë e protokolluar. Mostra SHZO102/2024 nuk ka pasur raporte të policëve. Lidhur me rastet me shënim zyrtar është konsultuar Prokurori kompetent. Shënimet zyrtare janë regjistruar në SIPK.

²¹ Planet operative: “Marsh me Motoçikleta organizuar nga FMK” (04/1-01Q-O/056/2023), “Shoqata Sindikale Siguria Fizike e KEK-ut” (05/3-01Q-/0088/23), “Akademia përkujtimore për Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka në Sallën e Kuqe/Pallatin e Rinisë dhe Sportit” (04/1-01Q-O007/22), “Futboll FC Prishtina vs Llapi (sekondare)” (05/3-01Q-/01/0215/2023) dhe “Manifestimi Pashkët Katolik” (04/1-01Q-O/036/2022).

²² Planet operative në zbatim: “Dorëza”, “Siguria në trafik” dhe “Targeti”.

²³ Mostrat e shënimeve zyrtare: SHZQ-102/2024, SHZQ-101/24, SHZQ-100/24, SHZQ-099/24, SHZQ-098/24, SHZQ-103/24, SHZQ-104/24, SHZQ-105/24, SHZQ-106/24 dhe SHZQ-107/24.

3. Parandalimi dhe luftimi i krimit

3.1. Neni 7 i Ligjit për Policinë përcakton se me qëllim të parandalimit e luftimit të krimit dhe për shtimin e sigurisë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, Policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet e qeverisë lokale, organizatat civile dhe komunitetet lokale. Strategjia për Policinë në Bashkësi reflekton zotimin policor dhe përkushtimin në ngritjen e sigurisë në bashkësi me anë të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve me gjithë akterët, që mbulojnë fushën e sigurisë në bashkësi dhe që në mënyrë preventive veprojnë në identifikimin e zgjedhjen e problemeve, që shkaktojnë shqetësime dhe frikë tek qytetarët. Plani i Veprimit në kuadër të objektivave strategjike ka përcaktuar numër të konsideruar aktiviteteve, ku veç tjerash janë përfshirë edhe: organizimi i takimeve për siguri nëpër shkolla, organizimi i takimeve me forume të sigurisë/mediat/OJQ-të, organizatat e ndryshme me qëllim të promovimit të strategjisë në bashkësi, identifikimi i pikave të zeza dhe problemeve në trafik, etj. Edhe Qeveria (MPB) ka nxjerrë Strategjinë Nacionale për Siguri në Bashkësi dhe Planin e Veprimit (2018-2023), ku ndër akterët e përfshirjes është edhe Policia. Lidhur me angazhimet policore në fushën e policimit në bashkësi, Stacioni pasqyron se:

- Në vitin 2022 janë realizuar 17 takime me forumet e sigurisë (KKSBB - KLSP), kurse në vitin 2023 janë realizuar 13 të tilla,
- Në vitin 2022 janë realizuar takime të shpeshta me DKA/drejtorë të shkollave dhe 34 ligjërata dhe vizita në shkolla, kurse në vitin 2023 janë realizuar takime të shpeshta me DKA-në, Këshillin e prindërve, drejtorë të shkollave dhe janë mbajtur 41 ligjërata dhe vizita në shkolla,
- Në vitin 2022 janë realizuar dy (2) takime me bizneset, kurse në vitin 2023 janë realizuar 13 takime të tilla,
- Në vitin 2022 është realizuar një (1) takim me komunitetin kulturor dhe sportiv, kurse në vitin 2023 janë realizuar 24 takime të tilla,
- Në vitin 2022 janë hartuar pesë (5) raporte për kushtet e trafikut dhe pikat e zeza, kurse në vitin 2023 është hartuar një (1) raport i tillë,
- Në vitin 2022 janë realizuar tetë (8) inspektime të rrugëve, kurse në vitin 2023 janë realizuar 16 inspektime të tilla,
- Për vitin 2022 nuk janë prezantuar të dhëna mbi projektet me komunitetin, kurse në vitin 2023 janë prezantuar dhjetë (10) projekte të tilla,
- Për vitin 2022 nuk janë prezantuar të dhëna mbi numrin e ligjëratave mbi aktivitetet e dyshimta lidhur me EDHRT, kurse në vitin 2023 është prezantuar një (1) aktivitet i tillë.

3.2. Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca është model pune dhe filozofi drejtuese, ku produktet e inteligjencës gjejnë përdorim të gjerë në procesin e vendimmarrjes, e që ka për qëllim parandalimin e reduktimin e krimit, si dhe zgjedhjen e problemit, duke u fokusuar në eliminimin e shkaktarëve, përmes menaxhimit strategjik dhe zbatimit efektiv të strategjive. Informata inteligjente është informatë e thjeshtë, që kalon në disa faza vlerësimi e verifikimi, ku në përfundim kemi produkt inteligjent, përmes të cilit parandalohet apo zgjidhet një problem. PUI nënkupton mbledhjen e informatave inteligjente për të vazhduar me parandalim dhe zgjidhje të problemeve, kështu që policimi në bashkësi do të ishte më efikas e efektiv. Stacioni në vitin 2022 ka dërguar 983 informata përmes SIPK-ut (Zyrtarit për Inteligjencë e Analizë, apo zyrtarëve policor), kurse, në vitin 2023 janë dërguar 815 informata. Sipas të dhënave për 41 stacione, në vitin 2023 ka pasur rënie të numrit të informatave inteligjente për -23.8% dhe kjo tendencë pasqyrohet edhe te Prishtinë Qendër me një rënie prej -17.1%. Sipas analizës për 41 stacione, pas trajtimit të këtyre informatave, njësitë përgjegjëse për analizë të inteligjencës gjatë vitit 2022, rreth 35% të tyre i kanë

shndërruar në raporte inteligjente, derisa në vitin 2023, rreth 47% e informatave janë shndërruar në raporte inteligjente. Tek Stacioni Policor Prishtinë Qendër këto kuota shënojnë 18.6% për vitin 2022 dhe 22.9% për vitin 2023. Me gjithë numrin e madh të informatave të dërguar nga Stacioni, e ulët është përqindja e raporteve inteligjente që derivojnë nga këto informata. Analiza e indikatorëve për stacionet pasqyron se mesatarja e informatave për polic është më e ulët në krahasim me mesataren për polic të Stacionit Policor Prishtinë Qendër.

Tabela nr. 11 - Të dhëna mbi grumbullimin e informatave dhe kualitetin e tyre si rezultat i Strategjisë së Udhëhequr nga Inteligjenca

Stacioni	2022		2022	
	Informata për polic	Raporte inteligjente për polic	Informata për polic	Raporte inteligjente për polic
Prishtinë Qendër	6.5	1.2	4.7	1.1
Stacionet ²⁴	4.2	1.5	2.9	1.3

3.3. Sipas nenit 10 të Ligjit për Policinë, ndër detyrat e përgjithshme të Policisë janë të parandalojë dhe zbulojë veprat penale dhe kryesit e tyre, si dhe të hetojë veprat penale dhe kryesit e tyre. Bazuar në këto autorizime, stacionet policore kanë detyra të ndara në parandalimin, hetimin e zbulimin e krimit. Niveli i kriminalitetit në zonën e përgjegjësisë së Stacionit Policor Prishtinë Qendër në vitin e fundit ka pasur trend rënës për 10.3% krahasuar me vitin paraprak. Kjo rënie është më e dallueshme krahasuar me trendin e rënies së nivelit të krimit në zonat e përgjegjësisë së 41 stacioneve policore e që është -2.6%. Nga analiza e suksesit të Stacionit kundrejt stacioneve tjera, Prishtinë Qendër në dy vitet e fundit ka shkallë të zbulueshmërisë së veprave penale nën nivel të mesatares për stacionet. Stacioni Policor Prishtinë Qendër, kuotat e tilla i ka pasur në lartësi prej 63.1% për vitin 2021, 59.3% për vitin 2022 dhe 62.6% për vitin 2023.

Diagrami 5 - Shkalla e zbulueshmërisë së krimeve (përqindja)



3.4. Për të vlerësuar respektimin e rregullave dhe procedurave hetimore, IPK-ja ka kontrolluar kopjet fizike të pesë (5) mostrave të rasteve të dhunës në familje, që janë proceduar në Prokurori të Shtetit²⁵. Në kuadër të rasteve është vlerësuar rregullsia e lëndëve penale, nëse ato përmbajnë veprimet/dokumentet e formularët e nevojshëm lidhur me hetimin e dokumentimin e krimit. Është verifikuar respektimi i disa prej veprimeve paraprake hetimore, përdorimi i formularëve standard brenda rasteve, si dhe regjistrimi i tyre sipas procedurës së regjistrimit të rasteve në regjistrat përkatës:

(a) Konform KPP-së, Stacioni ka ngritur kallëzime penale kundër të dyshuarve për veprën penale "Dhunë në familje". Të dhënat mbi rastet e marra si mostër janë regjistruar në SIPK. Një person (dëshmitar) i përfshirë në rastin 2023-AB-529, nuk është gjetur i regjistruar në Sistem. Po ashtu, lënda me numër 2023-AB-3392 nuk është regjistruar në SIPK brenda 24 orëve siç është paraparë me PSO. Kallëzimet penale janë dorëzuar në Prokurori bashkë me procesverbale, raportet

²⁴ Analiza e vitit 2022 mbulon performancën e 37 stacioneve, derisa ajo e vitit 2023, atë të 41 stacioneve.

²⁵ Dosjet me numër 2023-AB-804, 2023-AB-774, 2023-AB-130, 2023-AB-3392 dhe 2023-AB-529.

	<p>dhe format bazike të të dhënave të rasteve. Ato në dy raste nuk janë nënshkruar konform PSO-Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit²⁶. Lënda 2023-AB-804 është nënshkruar nga Shefi i Hetimeve dhe Mbikëqyrësi i vijës së parë në Sektorin e Hetimeve (Rreshteri), por jo dhe nga Hetuesi. Lënda 2023-AB-774 është nënshkruar nga Hetuesi dhe Shefi i Hetimeve, por jo dhe nga Mbikëqyrësi i vijës së parë në Sektorin e Hetimeve (Rreshteri). Lëndët janë proceduar në Prokurori përmes SMIL²⁷ dhe në formë fizike. Është verifikuar procedimi i lëndëve përmes SMIL dhe nga mostrat nuk janë hasur mangësi në futjen e dokumenteve. Është matur koha mesatare e procedimit të kallëzimeve në Prokurori, ku rezulton se rastet janë proceduar mesatarisht për 5.6 ditë.</p> <p>(b) Nga kontrolli i mostrave dëshmohej se në procesin e trajtimit të viktimave, në dy (2) raste janë përfshirë zyrtarë të QPS-së²⁸. Nuk është hasur pjesëmarrje e Mbrojtësit të Viktimave gjatë trajtimit të viktimave dhe në procesin e vlerësimit të rrezikut²⁹.</p> <p>(c) Viktimave të dhunës në familje u është ofruar trajtim mjekësor në dy (2) raste që dëshmojnë edhe raportet mjekësore, kurse në rastet tjera, ekzaminimet nuk janë pranuar, meqë viktimat e kanë vlerësuar të panevojshme.</p> <p>(d) Në fazën e veprimeve fillestare, Policia vlerëson rrezikun për viktimën e dhunës në familje në praninë edhe të Mbrojtësit të Viktimave. Lidhur me këtë, si pjesë e vlerësimit të rrezikut, Policia duhet të përgatisë formën bazike të të dhënave për rastin³⁰. Në të gjitha rastet e marra mostër është vlerësuar shkalla e rrezikut, bazuar në indikatorët përkatës, sipas formës standarde të paraparë me PSO.</p> <p>(e) Pakoja informuese për viktimat e krimit, që përmban Kartelën e viktimës me informata dhe këshilla mbi rastin, është obligative nga viti 2020, që të jetë pjesë e rastit dhe dosjes. Në kontrolli i dosjeve ka rezultuar se në një (1) rast, viktimat nuk është pajisur me Pakon e tillë³¹.</p> <p>(f) Në kuadër të kriterëve për kontrollimin e dosjeve është vlerësuar edhe prezenca e Raportit policor brenda dosjes hetimore, që i drejtohet Prokurorit kompetent për njoftim mbi dyshimin e arsyeshëm se është kryer vepra penale³². Në dosjen 2023-AB-3392 nuk është gjetur Njoftimi me shkrim për Prokurorin, i hartuar brenda afateve të parapara ligjore bazuar në KPP në fuqi.</p> <p>(g) Policia ka formularët e nevojshëm të punës, që iu shërbejnë zyrtarëve policorë gjatë kryerjes së veprimeve hetimore. Këta formularë brenda dosjeve hetimore janë unik në kuadër të Stacionit dhe ka një standard të caktuar të hartimit të tyre, mirëpo është gjetur që me rastin e ndryshimeve ligjore, të njëjtit ende nuk janë harmonizuar me aktet ligjore në fuqi (KPP i ri).</p> <p>(h) Policia luan rol me rëndësi në mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave</p>
--	--

²⁶ Sipas PSO-së, kallëzimet para procedimit nënshkruhen nga hetuesi, mbikëqyrësi i vijës së parë në Sektorin e Hetimeve (rreshteri) dhe përmes tij, nga Shefi i Hetimeve.

²⁷ Kur përfundon hetimi, hetuesi duhet të dërgoj lëndën për nënshkrim tek Mbikëqyrësi i vijës së parë në Sektorin e Hetimeve dhe përmes tij tek Shefi i Hetimeve. Më tutje, PSO përcakton se pas procedurave të lartcekura, hetuesi lëndën e regjistron në modulën për Sistemin SMIL dhe e përcjellë në Prokurorinë e Shtetit.

²⁸ Dosjet me numër: 2023-AB-3392 dhe 2023-AB-529.

²⁹ Sipas Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Mbrojtësi i viktimave është personi i autorizuar zyrtar, i cili ndihmon drejtpërdrejtë palën e dëmtuar që nga kontaktet e para me organet kompetente të mbrojtjes, këshillon, inicion procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes, është i obliguar të marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, të monitorojë mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.

³⁰ Kapitulli 5.2 i Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, faqe 33.

³¹ Dosja nr. 2023-AB-529.

³² Sipas nenit 71, paragrafi 6 të KPP-së, posa policia të pranoj kërkesën për ndjekje penale nga pala e dëmtuar ose posa të njoftohet se një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare është kryer, tentuar, është duke u kryer apo do të kryhet së shpejti, policia është e detyruar që menjëherë të njoftojë prokurorin e shtetit dhe t'i dorëzojë raport policor brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve.

	<p>themelore të njeriut³³. IPK ka vlerësuar respektimin e të drejtave në procedurë paraprake, gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarve/dëshmitarëve, ku dëshmohet të jenë nënshkruar nga ta. Deklaratat kanë përmbajtur të drejtat e personave të intervistuar, mirëpo ato duhet të harmonizohen me ndryshimet ligjore në fuqi.</p> <p>(i) Gjatë trajtimit të rasteve sipas procedurave standarde, stacionet policore duhet që viktimat t'i intervistojnë në hapësira të përshtatshme që ofrojnë komoditet dhe janë më të pranueshme sidomos në rastet kur viktimat janë personat e mitur. Këto hapësira duhet të jenë të pajisura me orendi dhe dekorim të brendshëm në mënyrë që të kryhen intervista në mjedise miqësore dhe të sigurta për viktimat e dhunës në familje. Stacioni Policor Prishtinë Qendër ka "dhomën mike" që ofron ambient të përshtatshëm për viktimat e dhunës në familje.</p> <p>(j) Gjatë zhvillimit të procesit hetimor ndaj personave të përfshirë si të dyshuar në ushtrimin e dhunës në familje, kur të njëjtit dyshohet se mund të jenë nën ndikim të alkoolit, duhet t'iu bëhet matja e promilëve në gjak përmes alkool testit dhe të evidentohet në raport. Stacioni është pajisur me alkool teste, që janë në funksion të zyrtarëve policor për të përmbushur të gjitha veprimet hetimore, për të dëshmuar se si rezultat i abuzimit me alkool, i dyshuari ka shkaktuar dhunë në familje, rrethanë kjo e rëndësishme për rastet.</p> <p>3.5. Sa i përket kushteve fizike e të sigurisë, Dhoma e dëshmive është e vendosur në vend të përshtatshëm brenda objektit të Stacionit dhe ofron hapësirë të mjaftueshme për funksionimin e saj. Dhoma ka vetëm zonën e deponimit të dëshmive, kurse zyra e pranimit është përballë kësaj Dhome dhe përdoret nga hetuesit. Muret, dyshemeja dhe tavani i Dhomës janë të rezistueshme ndaj sulmeve eventuale nga jashtë. Dera e Dhomës është e fortifikuar me një derë tjetër me grila metalike. Kapëset nyjore të derës janë të vendosur nga pjesa e brendshme e Dhomës. Çelësat rezervë ruhen në zarf të mbyllur në vend të sigurt (te përgjegjësi i Dhomës dhe Komandanti). Dhoma nuk ka dritare. Dhoma është e pajisur me sistem funksional të alarmit për raste të ndërhyrjes së paautorizuar. Dhoma është e pajisur me aparat për fikje të zjarrit me afat të skaduar. Dhoma ka detektorët e tymit dhe sistemi është në funksion. Sistemi i ventilimit e kondicionimit nuk është funksional. Dhoma siguron qasje të kufizuar për personat që e vizitojnë, ku çdo hyrje e personelit tjetër regjistrohet në Regjistër të qasjes. Dhoma është e monitoruar me kamera dhe sistemi mbulon brendësinë e Dhomës dhe hyrjen nga korridori. Sistemi deponon në mënyrë digjitale imazhet në procesor të serverit. Dhoma ka frigorifer për ruajtje të dëshmive biologjike. Nuk janë hasur dëshmi të rrezikshme, si: eksploziv, materie radioaktive, mjete zjarrvënëse, materie helmuese, apo materie kimike të natyrës së dëmshme. Dëshmitë e konfiskuara pranohen nga Zyrtari i Dhomës së dëshmive në zyrën e tij, bashkë me zinxhir të ruajtjes dhe të njëjtat deponohen në Dhomë, brenda orarit të punës.</p> <p>3.6. Sipas rregullit, çdo lëvizje e sendit, a dëshmisë duhet të regjistrohet në Regjistër dhe data bazë, dhe për të njëjtën duhet bashkëngjitur kopja e raportit të ekzaminimit, që duhet të ruhet në dosjet e Dhomës së dëshmive³⁴. Në të gjitha rastet e inspektuara janë evidentuar lëvizjet e dëshmive në mënyrën e duhur. Dëshmitë e deponuara në pesë (5) rastet e inspektuara kanë të bashkëngjitur zinxhirët e ruajtjes së bashku me</p>
--	--

³³ Bazuar në nenin 122 të KPP-së, në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, hetuesi i autorizuar nga Prokurori i Shtetit, para marrjes në pyetje i lexon dëshmitarit apo të dyshuarit paralajmërimet mbi të drejtat e rezervuara me Ligj dhe i njëjti duhet të konfirmoj me shkrim mbi të kuptuarit e të drejtave të lexuara nga hetuesi.

³⁴ PSO në kapitullin E, paragrafi 17 dhe 18 rregullon që çdo lëvizje e sendit/dëshmisë, të dorëzuar në gjykatë apo njësi tjetër, që i është kthyer pronarit apo personit të autorizuar, regjistrohet në Regjistër dhe në bazën e të dhënave. Nëse sendi dhe dëshmia është dorëzuar për ekzaminim/analiza në laboratorin kriminalistik, kjo lëvizje regjistrohet në Regjistër të dëshmive dhe data bazë. Kur dëshmitë me urdhëresë kërkohen nga Gjykata-Prokuroria, dorëzohen për ekzaminim/analiza apo ri-ekzaminim në laborator, kjo regjistrohet në Regjistër dhe data bazë, dhe për të njëjtën bashkëngjitet kopja e raportit të ekzaminimit, e cila duhet të ruhet në dosjet e dhomës së dëshmive.

dëshmi³⁵. Të dhënat për dëshmitë e deponuara janë evidentuar në Libër fizik dhe në Regjistër elektronik. Bazuar në mostrat, numri i dëshmime fizike (artikujve) të deponuar në Dhomë ka qenë në përputhje me informatat në Regjistër të dëshmime³⁶ dhe Zinxhirë të ruajtjes. Me PSO, origjinali i formës së zinxhirit të ruajtjes duhet të mbetet në Dhomë të dëshmime së bashku me sendin/dëshminë, ndërsa kopja, në dosjen e dëshmisë³⁷. Zinxhirët origjinal të ruajtjes mbahen në Dhomë të dëshmime.

3.7. IPK ka vlerësuar mënyrën e ruajtjes dhe evidentimit të sendeve të sekuestruara. Paketimi i dëshmime jo në të gjitha rastet është bërë duke iu përshtatur specifikave të tyre. Nga pesë (5) dëshmitë e verifikuara të lidhura me pesë (5) raste, në dy (2) prej tyre nuk janë paketuar në paketime adekuate (armë zjarri që lidhet me rastin 2023-AB-0754 është e vendosur në qese plastike dhe jo në pako letre, si dhe thikë që lidhet me rastin 2024AB-0083, e cila është paketuar në qese plastike dhe jo në pako letre). Dëshmitë tjera janë gjetur në paketime adekuate. Sa i përket vendosjes, a lokacionit ku ruhen dëshmitë, Stacioni përmbushë të gjitha kriteret e deponimit, meqë armët deponohen në arkë metali brenda zonës së deponimit, kurse bankënotat dhe gjërat e çmuara ruhen në sirtar metalik me kyç, lëngjet trupore ruhen në frigorifer. Zyrtari përgjegjës mbanë evidencë për sistemin e numrit, emërtimin e raftit, udhëzimin ku gjenden dëshmitë, apo sendet e deponuara dhe ka qenë i gatshëm që të identifikojë dëshmitë në kohë të shkurtër. I njëjti mbanë evidencë mbi dëshmitë në Librin e dëshmime dhe në Regjistër elektronik. Dëshmitë e inspektuara të lidhura me rastin 2023-AB-3408 (armë me gas dhe gëzhoja), si dhe dëshmia e lidhur me rastin 2024-AB-0083 janë gjetur të pasiguruara me shirit bllobues.

3.8. Me qëllim të ushtrimit të kontrollit adekuat, duke bërë rishikim formal periodik dhe verifikues për të vërtetuar korrektësinë e rrjedhën e punës, verifikim të pranishë së sendeve e dëshmime të mbajtura në Dhomë të dëshmime në krahasim me regjistrat, dhe të vlerësohet rrjedha e punës duke shikuar përmbushjen e procedurave, aspektin e sigurisë e kushtet e punës së zyrtarëve policor, organi kompetent duhet të realizojë revizion³⁸, inventarizim³⁹ dhe inspektim⁴⁰ në Dhomën e dëshmime. Janë prezantuar tre (3) raporte të revizioneve të realizuara në vitin 2022⁴¹ dhe katër (4) raporte të revizioneve të realizuara në vitin 2023⁴². Raporte të inspektimit dhe të inventarizimit nuk janë prezantuar për periudhën e mbulimit të inspektimit.

³⁵ IPK ka verifikuar dëshmitë që lidhen me pesë (5) raste: 2023-AB-0754, 2024-AB-0083, 2023-AB-0689, 2023-AB-3408 dhe 2022-AB-0444.

³⁶ PSO në kapitullin G, paragrafi 3 përkufizon se “regjistrat i dëshmime është një regjistër (formular apo libër) për regjistrimin e të gjitha dëshmime të konfiskuara apo provave të gjetura, të vjedhura etj. Të gjitha dëshmitë të cilat gjenden të deponuara në dhomë duhet të regjistrohen në regjistër të dëshmime.

³⁷ PSO - Dhoma e dëshmime, pika G, paragrafi 2 përkufizon se “zinxhiri i ruajtjes së sendit, pasurisë, provës apo parasë së gjetur është dokument apo formular i domosdoshëm që eidenton - prezanton konfiskimin, pranim-dorëzimin, ekzaminimin, lëvizjet, vendosjen dhe ruajtjen e sendeve dhe dëshmime, si dhe prezencën apo qasjen e zyrtarëve policor”.

³⁸ Revizioni është rishikim formal periodik dhe verifikues për të vërtetuar korrektësinë dhe rrjedhën e punës. Revizion i duhur është një inspektim i paanshëm i parimeve, procedurave dhe veprimeve për ta përcaktuar nëse apo jo, janë përcjellë standardet. Revizioni bëhet në bazë të një plani, i jashtëzakonshëm, kur ka informata se ka thyerje të integritetit të sistemit dhe kur kemi ndërrim të personelit.

³⁹ Inventarizimi është regjistrim dhe verifikim i pranishë së sendeve e dëshmime të mbajtura në Dhomë të dëshmime në krahasim me regjistrat. Zyrtari policor i sendeve dhe dëshmime duhet të kryej një inventarizim komplet së paku një herë në vit, çdo herë që ka ndërrim të personelit, apo me kërkesë të organit kompetent.

⁴⁰ Inspektimi është shikim apo këqyrje e punës, që duhet të jetë i shpejtë, joformal, zakonisht i paparalajmëruar, rishikim i procedurës, regjistrat, nëse Dhoma e dëshmisë është e pastër dhe në rregull, shëndeti i zyrtarit policor dhe siguria e tij, dëshmia e dorëzuar në mënyrë të rregullt, si dhe procedura standarde e operimit, a janë përfillur. Inspektimi periodik është menduar për të plotësuar e mbështetur revizionin e rregullt dhe inventarizimin e rregullt.

⁴¹ Raportet e revizioneve të datave: 09.02.2022, 05.05.2022 dhe 06.12.2022.

⁴² Raportet e inspektimeve të datave: 15.03.2023, 31.07.2023, 03.10.2023 dhe 27.12.2023.

4. Kushtet teknike të punës dhe të sigurisë

4.1. Stacioni ka 12 automjete, ku shtatë (7) nga to janë hasur në funksion (58%) dhe pesë (5) të tjera jashtë funksionit, duke qenë në proces të mirëmbajtjes (42%). Sipas menaxhmentit të Stacionit, ndërrimet kanë në dispozicion nga katër (4) automjete, të cilat mbulojnë katër (4) sektorët. Nga një inspektim i realizuar në vitin 2022, IPK-ja ka kryer analiza, që kanë pasqyruar se një (1) automjet zyrtar mesatarisht ka qenë në dispozicion të nëntë (9) punonjësve policor. Kjo mesatare dallon në Prishtinë Qendër dhe paraqet një gjendje më të pa favorshme, meqë sipas matjeve, një (1) automjet është në dispozicion të mesatarisht të 12 punonjësve. Por, kur krahasojmë numrin e punonjësve në raport me numrin e automjeteve funksionale, del se një (1) automjet është në dispozicion të mesatarisht 20 punonjësve. Parku i automjeteve të Stacionit ka një jetëgjatësi mesatare prej 4.7 vite, moshë kjo më e re krahasuar me moshën e përgjithshme të Flotës së automjeteve të Policisë (11 vjet). Sa i përket amortizimit teknik, automjetet e Stacionit kanë të kaluar mesatarisht nga 130.103 kilometra, që paraqet shkallë më të ulët të amortizimit në raport me mesataren e përgjithshme për tërë Flotën e Policisë, automjetet e së cilës sipas matjeve të vitit 2022, kanë pasur mesatarisht nga 217.640 kilometra të kaluara.

4.2. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës në nenin 6 dhe 7 ka përcaktuar detyrat e përgjegjësive në kontrollimin e automjeteve para përdorimit. Edhe Doracaku i Parimeve e Procedurave, në Parimin P-10.01 lidhur me shfrytëzimin e automjeteve, ka përcaktuar përgjegjësitë e detyrat e mbikëqyrësve/përdoruesve të automjeteve në mirëmbajtjen ditore sipas formularit të listës së verifikimit të automjetit. Nga inspektimi i pesë (5) automjeteve⁴³ rezulton se ato para përdorimit, nuk kontrollohen vizualisht nga ana e shfrytëzuesve dhe nuk iu verifikohet prezenca e pajisjeve rezervë sipas formularit standard të kontrollit të pajisjeve⁴⁴. Duhet cekur se Zyrtari i mbikëqyrjes së automjeteve realizon inspektime të rregullta javore, ku ka prezantuar edhe raporte zyrtare të datës 14.03.2024.

4.3. Neni 39 i Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete përcakton se në mënyrë që të marrin pjesë në trafik rrugor, mjetet duhet të jenë të regjistruar dhe të posedojnë certifikatë të regjistrimit të mjetit valide, ose leje valide për ngasje provuese, të jetë i shënuar me targë regjistrimi ose targa provuese të vendosura për identifikim të mjetit. Gjatë kontrollit të dokumentacionit të automjeteve, për katër (4) prej tyre ka pasur dokumentacion që dëshmon se ato janë të siguruara dhe regjistruara, kurse për një (1) automjet nuk ka pasur dokumentacion të tillë.

4.4. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës obligon çdo drejtues të automjetit zyrtar që në Fletë udhëtim të shënojë numrin e kilometrave të automjetit në momentin e nisjes, destinacionin e udhëtimit, qëllimin e udhëtimit, numrin e kilometrave të kaluara në momentin e kthimit dhe nënshkrimin e përdoruesit. Sa përket kësaj fushe, Udhëzimi respektohet plotësisht pasi fletë udhëtimet plotësohen rregullisht dhe përmbajnë të dhënat e nevojshme.

4.5. PSO për Flotën Operative përcakton që “mbikëqyrësi i secilës njësi që posedon automjete, duhet të sigurohet që ato të pastrohen në mënyrë periodike, jashtë dhe brenda, që t’i mirëmbahet pamja”. Sa i përket aspektit higjienik të automjeteve, është parë se kjo pikë nuk zbatohet sa duhet, meqë dy (2) nga automjetet janë hasur të papastrta, si brenda, ashtu edhe jashtë.

⁴³ Police 555-01, Police 191-03, Police 093-03, Police 221-03 dhe Police 218-03.

⁴⁴ IPK nuk ka siguruar formularët standard të kontrollit të automjeteve të ditës kur është realizuar inspektimi.


	<p>4.6. Neni 207 i Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor⁴⁵ përcakton që automjeti i udhëtarëve, kamioni dhe autobusi gjatë qarkullimit të tyre në trafikun rrugor duhet t'i posedojnë pajisjet rezervë dhe shtesë, si: poçet rezervë, kutinë e ndihmës së parë, trekëndëshin e sigurisë, pajisjen për tërheqje të mjetit në defekt, jelekun reflektues, ndërsa aparatën për fikje të zjarrit në rastet kur përdorimi i tij parashihet me ligj. Pajisjet duhet të jenë të kompletuara dhe me afat përdorimi. Sipas nenit 203 të Ligjit, shoferi gjatë drejtimit të mjetit duhet t'i mbaj me vete mes tjerash certifikatën e regjistrimit, policën e sigurimit dhe Raportin Evropian të Aksidentit. Sipas nenit 26 të Udhëzimit Administrativ (MI) nr.01/2018 për Kontrollimin teknik të automjeteve kontrollimi i pajisjeve rezervë dhe shtesë të automjetit përfshinë: çelësin e rrotave, ngritësen mekanike - hidraulike, gomën rezervë, trekëndëshin, aparatën e fikjes së zjarrit, ndihmën e parë, dritat rezervë, pajisjet e dimrit - zinxhirët. IPK-ja ka pasur fokus te Lista e pajisjeve të paraparë me legjislacionin e lartshënuar dhe inspektimi i pesë (5) automjeteve⁴⁶ nxjerrë në pah se katër (4) prej tyre janë të pajisura me pajisjet e nevojshme, kurse njërit nuk ka mundur t'i kryhet inspektimi, për shkak që bagazhi nuk i është hapur për shkaqe teknike (Police-191-03).</p> <p>4.7. Inspektorët kanë verifikuar masat e sigurisë brenda dhe jashtë Stacionit, si faktor me rëndësi për të siguruar burimet, pronën dhe palët. Sa i përket masave të sigurisë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Objekti mbulohet me sistem monitorimi përmes kamerave 24/7, rrezja e të cilit mbulon perimetrin e jashtëm dhe të brendshëm të tij⁴⁷. Sistemi mbikëqyret nga një dhomë e ndarë përmes monitorit, kurse administrohet nga DTIK-u, Porta para hyrjes së përparme të objektit të Stacionit është e mbuluar me policin statik, i cili komunikon me palët dhe i orienton ata. Në hyrje të objektit një polic pranon palët dhe evidenton hyrje - daljet në Regjistrin përkatës. Porta e dytë gjendet nga prapa parkingut, e cila shërben për hyrje-dalje të zyrtarëve policor dhe e cila mbikëqyret nga polici statik në hyrje të oborrin. Stacioni posedon magnetometrën dhe skanerin, me të cilin bëhet kontrolli fizik i personave që i qasen Stacionit, Aparatet për fikjen e zjarrit janë vendosur në pikat kyçe të objektit dhe janë kontrolluar/mbushur më 03.01.2024⁴⁸, Stacioni ka vend të ndarë për zbrazje të sigurt të armës, Higjiena brenda dhe jashtë Stacionit është e nivelit të dëshiruar. Stacioni ka Planin Operativ Emergjent "Evakuimi nga objektet policore në raste emergjente" (ref. 04/I-01SOR/55/2013, datë 12.12.2013), që ka përcaktuar përgjegjësitë e personelit për sigurinë. <p>4.8. Mjetet e punës janë faktorë me rëndësi për punë profesionale e të suksesshme. Janë pasqyruar disa vështirësi teknike në funksionimin e pajisjeve të kontraktuara (fotokopjeve), problem që sipas menaxhmentit po ndikon negativisht në aktivitetet administrative. Stacioni ka pasqyruar se ka këtë gjendje me pajisje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Printer/fotokopje - pesë (5) copë (funksional), - Kompjuter - 118 copë (funksional), - Pajisje për matje të shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve - 1 copë (funksional), - Alkooteste - 2 copë (funksional, por të pa kalibruar).
--	---

⁴⁵ IPK edhe gjatë këtij inspektimi i referohet këtij Ligji, megjithëse në ditën e inspektimit është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor.

⁴⁶ Automjetet e inspektuara: Police 001-03, Police 197-03, Police 225-03, Police 187-03 dhe Police 133-03.

⁴⁷ Neni 76 i Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton që personat në sektorin publik mund t'i instalojnë sistemin e vëzhgimit me kamera për vëzhgim të objektit nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe pasurisë.

⁴⁸ Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë, në nenin 13 parasheh që punëdhënësi të sigurojë numër të mjaftueshëm të aparateve për fikjen e zjarrit, të njëjtat të jenë me mbushje adekuate sipas llojit të shkaktarit të zjarrit. Këto duhet të vendosen në vende të përshtatshme, të jenë në gjendje të rregullt dhe të rimbushen në afate të caktuara.

	<p>4.9. Rregullorja (MF) nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore në nenin 18 përcakton që inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Kjo Rregullore përcakton tutje se organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jofinanciare. Procesi i inventarizimit është udhëhequr nga niveli qendror, ku është përfshirë dhe Stacioni. Për vitin 2023 është nxjerrë Raporti i inventarizimit të Komisionit tre anëtarësh më 22.12.2023.</p> <p>4.10. Rregullorja në fjalë përcakton që të gjitha organizatat buxhetore obligohen që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. IPK-ja ka verifikuar prezencën fizike në raport me Listën e pajisjeve - inventarit në pesë (5) zyra të Stacionit (103, 105, 108, 110, 115). Këto zyra kanë ekspozuar Listat e pasurive në vende të dukshme dhe të dhënat brenda tyre mbështeten nga prezenca e pajisjeve dhe inventarit brenda zyrave. Në Zyrën nr. 103 të Shefit të Operativës edhe pse ka pasur furnizim me shtëpizë dhe monitor, të dhënat nuk janë përfshirë në Listën e pajisjeve.</p>
<p>Përfundime</p> 	<p>1. Organizimi dhe burimet njerëzore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1. Stacioni ndodhet në fazën e ri-strukturimit organizativ si pjesë e Drejtorisë së Policisë së Kryeqytetit dhe është duke vijuar ri-sistemimi i personelit, duke marrë për bazë LPA-në, ku pritet të sanohen shmangiet në personel dhe grada. 1.2. Stacioni nuk mbanë Regjistrin e vijueshmërisë në punë të personelit, kurse orari i angazhimit ditor të personelit përputhet me gjendjen/prezencën fizike të tij në punë. Kapacitetet aktive në ndërrimin e natës dhe të paradites në ditën e inspektimit janë hasur në masën rreth 60% të personelit të ndërrimeve. 1.3. Inspektimi vë në pah që disa zyrtarëve policor u mungojnë disa prej pajisjeve policore, përfshirë, sprejin, radio lidhjet dhe jelekët anti-plumb, që dëshmohet edhe nga inspektimet e kryera nga drejtuesit policor. 1.4. Në stacion respektohet standardi i uniformës zyrtare dhe i dukjes personale. Ka shqetësime për mos furnizim të rregullt me veshmbathje zyrtare. 1.5. Kontrollat e armëve, municionit dhe pajisjeve policore janë të shpeshta dhe bëhen në baza të rregullta mujore nga drejtuesit e Stacionit. 1.6. Armëve dhe municionit u kushtohet kujdes i duhur sa i përket mirëmbajtjes, spreji dhe disa prej jelekëve janë hasur me afat të skaduar, apo të dëmtuar. 1.7. Realizimit të trajnimeve të brendshme dhe ricertifikimit duhet t'i jepet rëndësi më e madhe, meqë diku $\frac{3}{4}$ e orëve të planifikuara të trajnimeve të brendshme janë realizuar, sikurse që $\frac{3}{4}$ personelit të uniformuar janë ricertifikuar. 1.8. Janë identifikuar një numër hetuesish në Sektorin e Hetimeve që nevojitet të përfshihen në kurse bazike të hetimeve, si dhe trajtimin e dhunës në familje. 1.9. Shkeljet e lehta disiplinore në nivel të Stacionit janë trajtuar me kompetencë dhe brenda afateve. 1.10. Vlerësimi i performancës në punë është kryer në të gjitha mostrat, brenda afatit dhe sipas formularit standard. <p>2. Operativa:</p> <ol style="list-style-type: none"> 2.1. Me gjithë faktin se ka pasur përmirësim të evidencës së Logut operacional, ka nevojë edhe më tej në përditësimin e të dhënave në të, sepse shumë thirrjeve të qytetarëve nuk u pasqyrohet koha e reagimit nga njësitë policore.

	<p>2.2. Ka një zgjatje të kohës së përgjithshme të reagimit, që krahasuar me matjet e mëhershme ka shtuar vonesat në reagim, për shkak shtyrjes së ndarjes së detyrës në disa raste, si rezultat i nevojës për reagim me prioritet, kapaciteteve të kufizuara të burimeve njerëzore e logjistike, dhe qarkullimit të vështirësuar të trafikut.</p> <p>2.3. Varësisht prej niveleve drejtuese dhe operative, Stacioni kryen raportimet e nevojshme mbi aktivitetet policore. Fletë patrullat ka nevojë që teknikisht të përmbajnë të dhëna më të plota lidhur me aktivitetet.</p> <p>2.4. Procedimi i rasteve me raporte fillestare të incidenteve ka ndjekë procedurën dhe afatet kohore të trajtimit (adresimit).</p> <p>2.5. Njësitë patrulluese janë hasur të angazhuara në terren sipas Orarit ditor dhe nevojave për të reaguar në raste, dhe me përbërje të plotë konform Orarit ditor.</p> <p>2.6. Meqenëse metodologjia e patrullimit tek Stacioni dallon nga ajo për stacionet e kategorisë A (bëhet fjalë për raportin ndërmjet PK/PA), duhet të analizohen indikatorët, për t'u siguruar se kjo metodologjia aktuale praktikohet për shkak të patrullimit më të lehtë në zonë urbane, apo për arsye se ka nevojë për më shumë automjete.</p> <p>2.7. Nga mostrat që kanë rezultuar me konfiskim të patentë shoferëve, me masë mbrojtëse dhe me pikë negative, rezulton se ato janë regjistruar në evidencë elektronike dhe fizike. Gjobat janë shqiptuar të plota konform ligjit në fuqi. Dosjet nuk kanë vërtetim mbi konfiskimin dhe ka situatë kur nuk është nxjerrë procesverbal mbi ekzaminimin e pranisë së alkoolit te kundërvajtësit e testuar.</p> <p>2.8. Kuota e realizimit të urdhëresave të gjykatave vazhdon të jetë nën nivelin mesatar për stacionet, e përcjellur me një përqindje të lartë të atyre të bartura. Evidenca mbi urdhëresat e mbetura dhe të bartura është në përputhje.</p> <p>2.9. Stacioni duhet të angazhohet që lidhur me vizitat tek palët e kërkuara me urdhëresa, të ofrojë një pasqyrë më të pasur me informacion për veprimet policore të Stacionit drejt realizimit të urdhëresave.</p> <p>2.10. Të gjitha mostrat e urdhëresave që u kanë skaduar afatet, apo për të cilat ka pasur njoftime mbi tërheqjen (revokimin), janë shlyer me kohë nga SIPK.</p> <p>2.11. Numri i të arrestuarve dhe ndaluarve në raport me numrin e policëve, jep indikacione së përdorimi i forcës është në nivel të pranueshëm,</p> <p>2.12. Stacioni nuk është azhur sa duhet në verifikimin e kërkesave të palëve që kanë aplikuar për të kaluarën kriminale (vërtetimet), meqë janë hasur kërkesa të pa realizuara edhe pse ndaj parashtruesve të tyre nuk ka pasur raste të hapura.</p> <p>2.13. Janë përpiluar kënaqshëm plane që adresojnë shqetësimet e qytetarëve, apo që i kontribuojnë ngritjes së situatës së sigurisë. Për realizimin e planeve ka pasur procese të analizës - vlerësimit pas operativ të dëshmuara me raporte.</p> <p>2.14. Në ndërrimin e inspektuar, ekipet patrulluese kanë pasur disa plane operative në zbatim, gjë që e dëshmojnë edhe orari i patrullimit dhe fletë patrullat.</p> <p>2.15. Rastet me Shënim zyrtar janë trajtuar sipas standardit dhe janë të regjistruara në sistemin SIPK.</p> <p>3. Parandalimi dhe hetimi i krimit:</p> <p>3.1. Përgjithësisht gjatë vitit të kaluar ka pasur shtim të aktiviteteve në shumicën prej pikave në zbatim të Strategjisë për Policimin në Bashkësi.</p> <p>3.2. Edhe pse pasqyrohet se një polic i Stacionit ka performancë pozitive dhe atë mbi mesataren për polic të stacioneve, nuk duket që këtë sukses e mbështetë edhe pasqyra mbi numrin e raporteve inteligjente për polic.</p> <p>3.3. Në dy vitet e fundit, zbulueshmëria e veprave penale nga Stacioni ka qenë nën nivel të mesatares së përgjithshme të zbulueshmërisë për stacionet.</p>
--	---

- 3.4. Raportimi i dyshimit të arsyeshëm lidhur me veprën penale praktikohet me shkrim nga hetuesit për Prokurorin. Kallëzimet janë proceduar me kohë në Prokurori, me disa vërejtje sa i përket respektimit të zinxhirit komandues gjatë procedimit të tyre. Vlerësimi i rrezikut për viktimat është kryer rregullisht. Viktimat sipas nevojës i janë nënshtruar kontrollit mjekësor. Rastet mostër janë regjistruar në SIPK dhe SMIL. Formularët në dosje nuk janë azhurnuar me ndryshimet ligjore. Raportet ditore të rasteve të dhunës në familje në të gjitha rastet janë hartuar dhe u janë dërguar autoriteteve të përcaktuara me Ligj.
- 3.5. Kushtet teknike dhe të sigurisë brenda Dhomës së dëshmive edhe pse janë në pjesë të madhe të përmbushura, disa nga to duhet avancuar edhe më tutje.
- 3.6. Vërehen rezultate pozitive në mënyrën e ruajtjes së dëshmive dhe evidencës së tyre, por se ka vërejtje mbi materialet e përdorura të paketimit, që në disa raste nuk janë adekuate për dëshmitë specifike.
- 3.7. Inspektimet dhe inventarizimet si disa nga format e kontrollit dhe mbikëqyrjes në Dhomën e dëshmive nuk janë evidente, gjersa revizionet janë prezantuar të rregullta për vitin 2023.

4. Kushtet teknike të punës dhe të sigurisë:

- 4.1. Stacioni ka pasur në masë të konsideruar flotë jofunksionale operative. Moshja e përgjithshme e kësaj flote është më e re se ajo e Flotës operative të Policisë, me një gjendje jo të rënduar sa i përket amortizimit.
- 4.2. Automjetet policore nuk kontrollohen nga shfrytëzuesit para përdorimit, kurse inspektimet nga përgjegjësi i stacionit janë të rregullta.
- 4.3. Automjetet janë hasur të siguruara/regjistruara dhe se për shumicën prej tyre, Stacioni ka siguruar dokumentacionin e nevojshëm.
- 4.4. Fletë udhëtimet azhurnohen me kohë me të dhënat e nevojshme.
- 4.5. Disa prej automjeteve policore janë hasur të papastra brenda dhe jashtë, duke ofruar imazh jo të mirë tek qytetarët mbi këto asete policore.
- 4.6. Automjetet janë hasur të pajisura mirë me pajisjet rezervë, siç parashihet me legjislacionin në fuqi.
- 4.7. Masat e sigurisë janë të nivelit të pranueshëm.
- 4.8. Stacioni ka vështirësi sa i përket funksionimit të pajisjeve të zyrës (pajisjeve fotokopjuese), që ka efekt negativ në aktivitetet ditore.
- 4.9. Inventarizimi i pasurive është kryer, listat e pasurive janë hasur në zyra dhe të dhënat e tyre përputhen me prezencën fizike të pasurive. Lista në disa raste duhet rifreskuar me të dhëna për shkak të furnizimeve të reja.

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore ⁴⁹ (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Prishtinës, që të përshpejtojnë procesin e ri-strukturimit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër, si dhe ri-sistemimit të personelit (si pjesë e Drejtorisë së Policisë së Kryeqytetit), konform Strukturës Organizative dhe Listës së Autorizuar të Personelit. Përmbyllja e këtij procesi të marrë parasysh edhe shpërputhjet sa i përket numrit të punonjësve dhe gradave.	-I-		TM-IV 2024
2.	Për arsye sigurie dhe të nevojave, IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër, që bashkë me Drejtorin e Drejtorisë së Logjistikës, të përkujdeset në furnizimin e Stacionit me sprej kimik, jelek anti - plumb dhe radio lidhje.	-I-	Në baza të rregullta dhe periodike bëhen inspektime të pajisjeve zyrtare, dhe për të gjitha raportimet dhe mungesat e pajisjeve ngriten kërkesa vazhdimisht për furnizim. Sa i përket sprejit kimik, janë të njoftuar niveli rajonal dhe qendror dhe jemi në pritje për t'u furnizuar dhe shpërndarë te zyrtarët policor. Kërkesat për mungesë të pajisjeve si sprejit kimik, xhaketa anti plumb dhe radiolidhjeve procedohen me prioritet vazhdimisht për furnizim.	Në vazhdimësi
3.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit, që në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale dhe Divizionin e Trajnimeve, të ndërmarra hapa në drejtim të përfshirjes më të gjerë të zyrtarëve të uniformuar në programet e trajnimeve të brendshme brenda regjioni dhe atyre të ricertifikimit.	-I-	Sa i përket trajnimeve të brendshme, vazhdimisht bëhen planifikime dhe organizime të trajnimeve të brendshme në nivel të stacionit me tema specifike, dhe zyrtarët policor dërgohen më radhë në trajnim, si dhe në trajnimin e ricertifikimit që organizohet nga Drejtoria Rajonale, apo niveli qendror e caktojmë numrin e zyrtarëve për pjesëmarrje, duke bërë përpjekje që të respektohen afatet. Do të monitorohet caktimi dhe pjesëmarrja aktive e zyrtarëve policor në trajnime të brendshme dhe ricertifikim për një pjesëmarrje dhe më të madhe.	Në vazhdimësi
4.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër, që në	-I-	Duke pasur parasysh lëvizjet e personelit dhe sjelljeve të reja dhe rëndësinë e trajnimeve për personelin	Në vazhdimësi

⁴⁹ Komentet e strukturës policore janë përmbajtje e tekstit autentik të saj dhe në to nuk ka pasur ndërhyrje. Komentet janë pranuar me shkrim pas takimit përmblyllës të datës 31.07.2024, të realizuar nga përfaqësues të Departamentit të Inspektimit të IPK-së dhe strukturës policore të inspektuar.

	<i>koordinim me Divizionin e Trajnimeve, të ndërmarre hapa në drejtim të përfshirjes më të gjerë të personelit të caktuar të hetimeve në trajnime specifike profesionale (kursi themelor i hetimeve dhe kursi i trajtimit të dhunës në familje).</i>		<i>e hetimeve, do të identifikohen vazhdimisht zyrtarët e hetimeve, të cilët nuk e kanë të kryer trajnimet e duhura (kursi themelor i hetimeve dhe kursi i trajnimit të dhunës në familje, etj.) për të ngritur kërkesë për t'i dërguar zyrtarët në trajnim.</i>	
5.	<i>IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Operativës që të analizojnë dhe identifikojnë faktorët që mund të ndikojnë në ndarjen me vonësë të detyrave (caktimi i detyrave) tek patrullat policore dhe që mund të shtyjnë kohën e përgjithshme të reagimit policor në thirrjet e qytetarëve. Identifikimi i faktorëve ndikues duhet të pasohet me ndërmarje veprimesh, në drejtim të shkurtimit të kohës së reagimit.</i>	-I-	<i>Sipas një vlerësimi të kryer, disa nga faktorët ndikues mund të jenë volumi dhe intensiteti i lartë i punës, mungesa e personelit kundrejt kërkesave dhe informatave të pranuara nga qytetarët, ku dhe mbikëqyrësit në detyrë obligohen të caktojnë prioritetet të angazhimit të njësive sipas peshës së rasteve të raportuara dhe informatave të pranuara, si dhe një tjetër faktor ndikues me rëndësi evidentimi i aktiviteteve policore në llogj operacionale. Nga stafi komandues, posaçërisht nga sektori i operativës, do të monitorohen caktimi i detyrave dhe oraret e angazhimit, mbulimi i zonave me patrullime të rregullta e sektoriale, shpërndarja e detyrave dhe personelit sipas prioriteteve, caktimi i zyrtarëve në radio komunikim dhe që kanë njohuritë e duhura për mirëmbajtjen e llogj operacionale, monitorimi dhe mbikëqyrja e shtuar në ndërmarjen e veprimeve policore me kohë në drejtim të shkurtimit të kohës së reagimit, dhe evidentimin e duhur në regjistrin e aktiviteteve policore.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
6.	<i>IPK-ja i rekomandon Shefit të Operativës së Stacionit Policor Prishtinë Qendër, që të sigurohet se dosjet e kundërvajtjeve të trafikut, të përcjellura me konfiskim të patentë shoferëve, të jenë të plota dhe të përmbajnë edhe vërtetimet e konfiskimit, si dhe procesverbalet e ekzaminimit të prezencës së alkoolit, për rastet kur janë kryer testimet.</i>	-I-	<i>Sa i përket vërtetimit mbi konfiskimin e dokumenteve për kundërvajtje në trafik, si dhe plotësimin e procesverbalit mbi ekzaminimin e prezencës së alkoolit gjatë testimit, do t'iu shpërndahen format gjithë personelit përmes mbikëqyrësve, monitorimi direkt i zbatimit do të bëhet nga mbikëqyrësit e ndërrimit, si dhe nga personeli i sektorit të operativës, respektivisht zyrtarët e SIPK, të cilët nuk do të procedojnë asnjë lëndë të pakompletuar në sistem, por do të njoftojnë shefin e sektorit të operativës për të trajtuar me kohë çdo rast të paraqitur.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
7.	<i>IPK-ja iu rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër dhe Shefit të Operativës, që të mobilizohen në</i>	-I-	<i>Te realizmi i urdhëresave të gjykatës, si stacion kemi pasur ngritje të realizmit të urdhëresave në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 për +19.3%,</i>	<i>Në vazhdimësi</i>

	<i>përmirësimin e performancës së Stacionit në ekzekutimin e urdhërësive të gjykatave, për derisa njësitë policore ngarkohen me to.</i>		<i>respektivisht në vitin 2023 janë realizuar 1.284 urdhëresa, njësheu këtë vit në kohën e këtij raporti jemi me realizim edhe më mirë se në vitin 2023, ku në gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 (Janar-Qershor) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, kemi ngritje në realizim të urdhërësive për +18.1%. Sipas strukturës organizative nuk kemi njësi të veçantë për urdhëresa, por në realizimin e tyre angazhohen të gjitha njësitë e stacionit, si dhe zyrtarët e caktuar në plane operative. Duke pasur parasysh numrin e madh të urdhërësive që pranojmë rregullisht nga gjykata, kemi propozuar që në strukturën e stacionit të parashihet edhe kjo njësi. Do të bëjmë përpjekje që të rritet numri i realizimit të urdhërësive edhe më tutje.</i>	
8.	<i>IPK-ja iu rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër dhe Shefit të Operativës, që të ushtrojnë kontrollin mbi njësinë përkatëse që merret me ekzekutimin e urdhërësive, që për të gjitha veprimet policore në drejtim të ekzekutimit të tyre, të mbahet evidencë, e cila duhet dokumentuar brenda përmbajtjes së dosjes (të mbahen formularë të veçantë mbi vizitat tek personat e kërkuar).</i>	-I-	<i>Deri më tani nuk kemi pasur ndonjë formular unik dhe veprimet policore janë evidentuar me raport polici. Pas këtij rekomandimi, në nivel stacioni ne do të hartojmë një formular të përshtatshëm i cili do t'i bashkëngjitet urdhërësës në momentin e pranimit dhe do të evidentohen të gjitha angazhimet policore në zbatim.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
9.	<i>IPK-ja iu rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër dhe Shefit të Operativës, që të ushtrojnë kontrollin mbi respektimin e afateve në lëshimin me kohë të vërtetimeve për parashtruesit e kërkesave për verifikim të të kaluarës kriminale, për rastet kur për ta nuk ka dosje të hapura.</i>	-I-	<i>Me fillimin e parashtrimin të kërkesave nga palët për vërtetimin e kaluarës kriminale (VKK) përmes sistemit elektronik në platformën e-Kosova e ka bërë të mundshme që çdo qytetar, pavarësisht ku banon, të aplikojë për vërtetim në stacionin policor që ai dëshiron. Këtë aplikim mund ta kryejnë edhe shtetasit e Kosovës që janë jashtë vendit, ku kjo ka bërë që të rritet shumë dhe numri i kërkesave për VKK. Vetëm në gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 (Janar - Qershor) janë pranuar 4.932 kërkesa për t'u pajisur me vërtetim mbi verifikimin e të kaluarës, nga to 4.281 janë kërkesa të pranuar përmes platformës e-Kosova. Në këtë drejtim, struktura e re organizative në kuadër të Stacionit Policor Qendra ka paraparë vetëm 3 zyrtarë (1 polic dhe 2 staf civil) në</i>	<i>Në vazhdimësi</i>

			zyrën e SIPK-ut dokumenteve dhe arkives, detyra e tyre është të merren me regjistrim në sistem të të gjitha rasteve, urdhëresave, tiketave, aksidenteve, shënimeve zyrtare, pranojnë kërkesa të palëve për dokumentet e humbura dhe vërtetime të të kaluarës dhe merren me arkivim, ku sipas vlerësimeve të bëra mbi volumin e madh të punës në këtë njësi, kemi propozuar të kemi një numër më të madh të personelit dhe me strukturë. Përveç angazhimit të zyrtarëve nga stacioni, në lidhje me këtë çështje nga Drejtoria Rajonale e Policisë - Prishtinë kemi kërkuar asistim ku dhe janë duke asistuar me zyrtarë nga zyra e SIPK-ut Rajonal për trajtimin e kërkesave për VKK të pranuar përmes platformës e-Kosova.	
10.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër dhe Shefit të Hetimeve, që gjatë ushtrimit të kontrollit mbi lëndët para se ato të procedohen në Prokurorinë e Shtetit, të respektohet i tërë zinxhiri komandues përgjatë rrugëtimit të tyre (të respektohet hierarkia e kontrollit në mënyrë që kallëzimet të kalojnë nga hetuesi i lëndës, tek mbikëqyrësi i vijës së parë dhe më pas tek Shefi i Sektorit të Hetimeve konform Procedurës Standarde të Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit).	-I-	Përkundër që mbikëqyrësit nga sektori i hetimeve e kontrollojnë lëndën dhe kanë nënshkruar në fund të kallëzimeve penale, ne do të shtojmë mbikëqyrjen në këtë pikë që të mos tejkalohet asnjë rast i vetëm pa u nënshkruar nga të gjithë të përfshirët në shkresa zyrtare, duke filluar nga hetuesi i lëndës, mbikëqyrësi i parë dhe më pas nga shefi i sektorit të hetimeve. Në rastet e natyrës urgjente kur ka të arrestuar dhe duhet dërguar rasti në Prokurori jashtë orarit të rregullt të punës dhe vikendeve do të veprohet sipas PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit).	Në vazhdimësi
11.	IPK-ja i rekomandon Zyrtarit të Dhomës së dëshmive, që të respektojë rregullat mbi paketimin e dëshmive të konfiskuara në materiale adekuate, varësisht prej specifikave të tyre.	-I-	Sa i përket paketimeve të dëshmive, edhe përkundër kërkesave të shumta, shpesh herë ka mungesë dhe vonesa në furnizim të materialeve për paketimin e dëshmive. Do të ushtrohet mbikëqyrje dhe Zyrtari i Dhomës së dëshmive nuk do të pranojë dëshmitë në rast se nuk janë paketuar si duhet nga hetuesit, respektivisht krim teknika.	Në vazhdimësi
12.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër, që në Dhomën e dëshmive të ushtrohen kontrole përmes inspektiveve të paparalajmëruara dhe inventarizimet, drejt administrimit të duhur të dëshmive.	-I-	Inspektimi/Revizioni i Dhomës së Dëshmive të Stacionit Policor Qendër për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 (Janar-Qershor) është si vijon: - Inspektimi i Dhomës së dëshmive nga niveli qendror (DPP) është kryer me datën 02.02.2024, - Revizioni për tre mujorin e parë është kryer me datën 26.03.2024.	Në vazhdimësi

			<p>- Inspektimi i Dhomës së dëshmisë nga niveli rajonal (DRP-Prishtinë) është kryer me datën 17.05.2024.</p> <p>- Inspektimi i paparalajmëruar i Dhomës së dëshmimeve nga eprorët e Stacionit (Komandanti, Zëvendës Komandanti dhe shefi i sektorit të hetimeve është kryer me datën 07.06.2024.</p> <p>Inspektimet dhe inventarizimi/revizioni janë kryer në Dhomën e dëshmimeve rregullisht, ku dhe do vazhdojen të kryhen sipas rregullave të përcaktuara.</p>	
13.	<p>IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor Prishtinë Qendër dhe Shefit të Resurseve, që të ushtrojnë kontrole të paparalajmëruara lidhur me kontrollin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve.</p>	-I-	<p>Në kuadër të planifikimit të orarit të inspektimeve të rregullta janë inspektuar vazhdimisht angazhimet e gjithë personelit së bashku me uniformën dhe pajisjet personale të zyrtarëve, si dhe përdorimi i veturave zyrtare, ndërsa inspektimi i rregullt javor i veturave është kryer nga zyrtari që është marrë me çështje logjistike. Me strukturën e re të stacionit nuk ka më sektor të resurseve ku dhe inspektimi në lidhje me kontrollin dhe shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare do të bëhet në kuadër të inspektimeve nga stafi komandues i stacionit.</p>	Në vazhdimësi

Shtojca

Tabela nr. 1 - Pasqyrë mbi burimet njerëzore të Stacionit Policor - Prishtinë Qendër				
Kategoria	Burimet e planifikuara (28.02.2019)	Gjendja me burime (më 31.12.2023)⁵⁰	Burimet sipas LPA-së (10.07.2023)	Gjendja me burime (më 20.03.2024)
Personel i uniformuar	165	172 (+7)	111	134 (+23)
Shërbyes civil	10	6 (-4)	4	5 (+1)
Gjithsej	175	178 (+3)	115	139 (+24)

Tabela nr. 2 - Pasqyrë mbi treguesit e performancës lidhur me reagimin në thirrjet e qytetarëve		
Treguesi (indikatori)	Matjet për Prishtinë Qendër (2022)	Matjet për Prishtinë Qendër (2024)
Numri i mostrave	3.253	1.213
Koha e përgjithshme e reagimit policor	13.2	14.5
Raporti në % ndërmjet reagimit me kohë/të shtyrë	74/26	66/34

Tabela nr. 3 - Pasqyrë mbi treguesit e performancës lidhur me ekzekutimin e urdhëresave		
Treguesi (indikatori)	Viti 2022	Viti 2023
Urdhëresa të bartura nga vitit paraprak	611	743
Urdhëresa të pranuar gjatë vitit	1.247	1.243
Totali i urdhëresave të disponueshme gjatë vitit	1.858	1.986
Urdhëresa të ekzekutuara	1.076	1.284
Urdhëresa të parashkuara	39	72
Urdhëresa të mbetura në fund vit	743	630

Tabela nr. 4 - Pasqyrë mbi treguesit e performancës lidhur me patrullimet dhe gjobat e trafikut		
Treguesi (indikatori)	2022	2023
Patrullime në këmbë (PK)	2.615	2.643
Numri i patrullimeve me automjet (PA)	2.920	2.926
Numri i pikave të kontrollit të automjeteve (PKA)	3.452	3.460
Numri i gjobave të shqiptuara	14.254	16.114

Tabela nr. 5 - Pasqyrë mbi indikatorët e performancës në hetimin dhe zbulimin e krimit		
Indikatorët e performancës	2022	2023
Vepra penale	2.142	1.921

⁵⁰ IPK-ja ka krahasuar kapacitetet e burimeve njerëzore në fund të vitit 2023, duke marrë parasysh Strukturën e vjetër, meqenëse më 31 dhjetor 2023, ende ka qenë në funksion Struktura e vjetër organizative.